LIGJ
Nr.9633, datë 30.10.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES "PLANI I VEPRIMEVE TË PROGRAMIT PËR SHQIPËRINË 2006-2010" NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PROGRAMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM (PNUD)"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja "Plani i veprimeve të programit për Shqipërinë 2006-2010" ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD)".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5119, datë 20.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara

PNUD-i dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë kanë rënë në një marreveshje të përbashkët në lidhje me përmbajtjen e këtij dokumenti dhe përgjegjësitë përkatëse në zbatimin e Planit të Veprimeve të Programit për Shqipërinë (PVPSH) 2006-2010.
Duke çuar me tej marrëveshjen e përbashkët dhe bashkëpunimin për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjecarit, si dhe konventave dhe samiteve të Kombeve të Bashkuara në të cilat janë angazhuar Qeveria Shqiptare dhe PNUD-i,
Duke shfrytezuar përvojen e fituar dhe progresin e arritur gjatë zbatimit të programit të mëparshëm të vendit (2002 deri më 2005),
Duke hyrë në një periudhë të re bashkëpunimi nga 1 janari 2006 deri më 31 dhjetor 2010,
Deklarojnë se keto përgjegjësi do të përmbushen në frymën e bashkëpunimit të ngushtë dhe bien dakort për sa më poshtë:

PJESA I. BAZA E MARRËDHËNIEVE

1.1 Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (të cilit në vijim do t'i referohemi si "KM") dhe Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (të cilit në vijim do t'i referohemi si PNUD) kanë hyrë në një marrëveshje të përbashkët e cila drejton ndihmën e PNUD-it për Shqipërinë (Marrëveshja Standarde e Ndihmës Bazë - 'MSNB') dhe që u firmos nga të dyja palët me 17 qershor 1991. Në bazë të Nenit 1, paragrafi 2 të MSNB, ndihma e PNUD-it ndaj qeverisë do t'i paraqitet KM dhe do të jepet dhe pranohet në përputhje me rezolutat dhe vendimet përkatëse e të zbatueshme të organeve kompetente të PNUD-it, si dhe në varësi të disponueshmërisë së fondeve të nevojshme nga ana e PNUD-it. Në veçanti, vendimi 2005/1 i datës 28 janar 2005 i Bordit Ekzekutiv të PNUD-it miratoi Rregulloret dhe Normat e reja Financiare dhe së bashku me to dhe përkufizimet e reja në lidhje me termat 'realizim' dhe 'zbatim', të cilat i krijojnë mundësinë PNUD-it të zbatojë tërësisht Proçedurat e reja të PVPSH 2006-2010 që rrjedhin nga nisma e thjeshtëzimit dhe harmonizimit të Grupit të Zhvillimit të KB (GZHKB).

PJESA II. ANALIZË E SITUATËS

2.1 Shqipëria ka ecur përpara përsa i përket krijimit të bazave për institucione demokratike dhe ekonomi tregu. Në vitin 1998 Shqipëria miratoi Kushtetutën e re, e cila përfaqson një angazhim kolektiv për të respektuar parimet demokratike, të drejtat e njeriut, mundësitë e barabarta dhe ekonominë e tregut. Shqipëria ka identifikuar gjithashtu një Objektiv të 9-të për Zhvillimin e Mijëvjeçarit (OZHM), i cili bazohet mbi "vendosjen dhe forcimin e proçesit të mirë-qeverisjes" siç paraqitet në Raportin Kombëtar të Shqipërisë mbi OZHM-të të vitit 2004. Përveç kësaj, në vitin 2000 Shqipëria u bë anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), gjë që tregon vendosmërinë e saj për të ndërtuar një ekonomi tregu të hapur dhe të integruar.

2.2 Siç vihet në dukje në Dokumentin e PVPSH 2006-2010 të PNUD-it, megjithë arritjet e bëra, varfëria në Shqipëri mbetet ende një problem i mprehtë; rritja domethënëse e të ardhurave dhe përmirësimet në disa nga treguesit e zhvillimit kanë treguar nivele të pabarabarta arritjesh. Treguesit vënë në dukje se vetëm disa zona dhe pjesë të popullsisë kanë patur përfitime. Ndërsa Raporti Kombëtar i Shqipërisë mbi OZHM i vitit 2004 vë në dukje se Shqipëria po ecën në rrugën e duhur drej arritjes së Objektivit 1, ende ka arsye të dukshme për t'u shqetësuar. Me të ardhura për frymë prej 1,740 dollarë amerikanë në vitin 2003 dhe përafërsisht një të katërtën e popullsisë me një konsum më të ulët se nivelet e varfërisë, Shqipëria mbetet një nga vendet më të varfëra në Europë. Në Shqipëri vihet re një dimension i fortë rajonal i varfërisë – me mbi 50% të popullsisë në zonat rurale dhe të largëta (sidomos në Shqipërinë veri-lindore) që jeton në varfëri[1]. Varfëria paraqet gjithashtu dhe një dimension të fortë gjinor me mospërputhje domethënëse ndërmjet

[1] Raporti Kombëtar i Shqipërisë mbi OZHM-të i vitit 2004

statusit të grave dhe burrave në tregun e punës. Ndërsa disa tregues sugjerojnë arritje në disa nga fushat kyçe të tilla si: varfëria absolute, vdekshmëria foshnjore, shëndeti i nënës, arsimimi i të rinjve dhe grave të reja, numri i ulët i të dhënave pengon kryerjen e një vlerësimi të detajuar.

2.3 Shqipëria është ende një demokraci e re. Shkalla e zbatimit të ligjit mbetet ende në nivele të ulta, pavarësisht nga përpjekjet për të forcuar funksionimin e sistemit gjyqësor. E lidhur ngushtë me të është dobësia e administratës publike (treguesit e efektshmërisë të së cilës mbeten në shkallë të ulët, pavarësisht nga disa përmirësime) si dhe e mekanizmave kombëtare për barazinë gjinore, të cilët duhet të institucionalizohen më tej. Ngritja e një administrate publike moderne, të pavarur dhe efikase mbetet një objektiv afat-gjatë. Siç vihet re në Vlerësimin e Përbashkët Për Vendin për vitin 2004, korrupsioni në masë dhe krimi i organizuar përbëjnë një rrezik serioz për mirëqënien e vendit si dhe aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

2.4 Qeveria e Shqipërisë ka formuluar dhe po zbaton SKZHES (Strategjinë Kombëtare për Zhvillim Ekonomik dhe Social). Qeveria dhe Komisioni Europian kanë përfunduar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA). SKZHES dhe MSA po kthehen në forume të institucioneve të interesuara për të arritur një konsensus në lidhje me përparësitë e qeverisë. Programi i Buxhetit Afat-Mesëm (PBAM) dhe buxheti kombëtar janë planifikuar në mënyrë të tillë që të mund të mbështesin financiarisht përparësitë e qeverisë, të cilat identifikohen në SKZHES dhe MSA. Sidoqoftë lidhja e përparësive të politikave me fazat e tjera të ciklit të politikave mbetet një problem kritik; përparësitë nuk janë përcaktuar siç duhet në lidhje me treguesit e matshëm dhe buxhetin si dhe nuk janë programuar, monitoruar dhe vlerësuar në mënyrën e duhur. Për më tepër, sistemet dhe kuadret e planifikimit, monitorimit dhe raportimit mbeten të shkëputura nga njëri-tjetri dhe janë ende të pabazuar mbi analizat gjinore.

2.5 Vitet e fundit qeveria është përballur me pengesat që vijnë nga një kuadër i fragmentuar planifikimi për zhvillimin, i cili përfshin një numër axhendash, shumë prej të cilave mbështeten nga anëtarë të ndryshëm të komunitetit të donatorëve ndërkombëtarë. Për t'iu përgjigjur kësaj situate qeveria ka zhvilluar një Sistem Planifikimi të Integruar (SPI), i cili sjell së bashku axhendat e ndryshme brenda një kuadri efektiv dhe tërësor. Zbatimi i SPI-së duhet të perfundojë në fillim të vitit 2006. Ky sistem sjell se bashku SKZHES-në, MSA-në e mbeshtetur nga BE-ja si dhe OZHM-të. Brenda kuadrit të SPI-së, instrumentet e ndryshme të planifikimit janë të lidhura drejtpërsëdrejti me buxhetin vjetor nëpërmjet PBAM.

2.6 Zhvillimi i sektorit privat ka luajtur një rol kyç në ofrimin e mundësive të punësimit si dhe ofrimin e infrastrukturës kyçe, e cila është e nevojshme për zhdukjen e varfërisë, megjithëse deri më sot kjo ka qënë e një shkalle relativisht të ulët. PNUD-i ka ndërmarrë një sërë nismash në mbështetje të rritjes së sektorit privat ku përfshihen ndërmarrja e studimeve të fizibilitetit [mundësisë] në lidhje me tregtinë ndërkufitare (sidomos ndërmjet territorit të Kosovës të administruar nga KB dhe rajonit të Kukësit), ndërmarrja e një misioni formulimi për ngritjen e një inkubatori biznesi në rajonin e Fierit, dhe mbështetja për qeverinë shqiptare (në veçanti për Ministrinë e Ekonomisë Tregëtisë dhe Energjetikës) në lehtësimin dhe liberalizimin e tregtisë nëpërmjet forcimit të ligjit sipas legjislacionit ndërkombëtar të tregtisë.

2.7 Shqipëria ka bërë përpjekje të konsiderueshme drejt krijimit të kuadrit ligjor dhe institucioneve bazë si dhe drejt zbatimit të politikave që synojnë decentralizimin. Sidoqoftë, hapat që Shqipëria duhet të ndërmarrë përfshijnë: formulimin e decentralizimit politik, administrativ dhe fiskal në mënyrë që të përmirësohet ofrimi i shërbimeve, qeverisja si dhe të rritet shkalla e përgjegjësisë. Analiza e çështjeve kyçe dhe lidhjet e tyre të brëndshme vënë në dukje nevojën për një investim më të madh në fushën e transportit, energjisë, ujit dhe kanalizimeve si dhe të rehabilitimit të infrastrukturës sociale.

2.8 Kushtetuta e Shqipërisë përcakton barazinë midis gruas dhe burrit, megjithatë, në realitet gratë shpesh nuk gëzojnë status të njëjtë me burrat. Siç edhe vihet në dukje në Raportin Kombëtar të Shqipërisë mbi OZHM-të të vitit 2004, ndërsa nuk paraqiten ndryshime të pazakonta në nivelet e arsimit dhe punësimit në administratën publike (në të vërtetë, në raport shkruhet se Shqipëria po ecën në rrugë të mbarë drejt arritjes së Objektivit 3), pabarazia gjinore, dhe shkollimi i grave në zonat rurale janë çështje që përbëjnë shqetësim. Për më tej dhuna kundrejt grave pranohet si një problem social i njohur në rritje. Vlerësimi i Përbashkët Për Vendin i KB i vitit 2004 vë në dukje se përpjekjet e bëra nuk kanë qënë të mjaftueshme për krijimin e një mjedisi mbrojtës për gratë, sidomos në zonat e largëta.

2.9 Që në fillim të viteve '90-të, Shqipëria ka bërë përpjekje të rëndësishme përsa i përket demokratizimit dhe përfshirjes të të drejtave të minoriteteve në sistemin e saj ligjor në kuadrin e angazhimeve ndërkombëtare dhe rajonale. Popullsia Rome dhe Egjiptiane mbeten gjithësesi si pjesa më e pafavorizuar e popullsisë. Rënia e komunizmit shënoi rënien e tyre nga një mirëqënie financiare në varfëri ekstreme. Sipas dokumentit të Bankës Botërore të titulluar "Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri", përafërsisht 80 përqind e popullsisë rome dhe egjiptiane klasifikohet si "shumë e varfër" në krahasim me 20 deri në 30 përqind të pjesës tjetër të popullsisë. Dokumenti i Bankës Botërore tregon më tej se përqindja e analfabetizmit ndër romë është 62.2 përqind dhe 23.5 përqind ndër egjiptiane, me një numër vitesh shkollore të përfunduara respektivisht 4.02 dhe 5.05 vjet. Veç kësaj, dokumenti vë në dukje se një faktor specifik i përjashtimit është mungesa e dokumentave bazë të tilla si çertifikatat e lindjeve, (martesat janë kryesisht të paregjistruara) dokumentat e identifikimit, të cilat kanë të bëjnë me ndihmën sociale që ofrohet nga shteti si dhe pasaportat. Për të përmirësuar kushtet e varfëra me të cilat përballen minoritetet e pafavorizuara, qeveria po mbështet një Strategji Kombëtare për Romët, duke krijuar struktura të veçanta qeveritare që do të garantojnë zbatimin e saj. Sidoqoftë, mungesa e kapaciteteve dhe burimeve paraqet vështirësi në arritjen e rezultateve të pritshme . "Dekada e Përfshirjes së Romëve" u ofron mundësinë institucioneve të interesuara shqiptare të përkrahin dhe njohin komunitetet rome dhe egjiptiane dhe të krijojnë mjedise të favorshme për mirëqënien e tyre ekonomike dhe sociale.

2.10 Shqipëria është një vend me një diversitet biologjik të pasur. Siç del në pah në Raportin Kombëtar të Shqipërisë për OZHM-të të vitit 2004, Shqipëria është në rrugë të mbarë drejt arritjes së Objektivit 7. Sidoqoftë një vëmendje më e madhe i duhet kushtuar mjedisit mbështetës. Pavarësisht se janë njohur arritje, sipërfaqja e zonave aktuale të mbrojtura mbetet e pamjaftueshme për të siguruar ruajtjen efektive të këtij burimi. Për më tej, integriteti biologjik i zonave aktualisht të mbrojtura është kompromentuar si rezultat i gjuetisë së paligjshme si dhe prerjes së paligjshme të drurëve. Në përgjithësi bihet dakort se ndotja atmosferike, sidomos në qendrat më të mëdha urbane, është një problem i rëndësishëm. Mbetjet e qëndrueshme përbëjnë gjithashtu një faktor madhor të ndotjes, sidomos në zonat urbane. Monitorimi dhe zbatimi shfaqen në një nivel të papërshtatshëm dhe ende nuk janë formuluar plane menaxhimi të detajuara. Pikat e nxehta mjedisore mbeten ende sfida më e madhe ndër faktorët e tjerë social-ekonomike. Secila prej këtyre vendndodhjeve paraqet probleme serioze, të cilat mund të sjellin rreziqe të menjëhershme për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin.

2.11 Intensiteti i dhënies së ndihmës për Shqipërinë tregon tendenca në rritje që nga viti 2002 sa i përket ndihmës zyrtare të zhvillimit neto. Në vititn 2002, Shqipëria mori 309 milionë dollarë, ndërsa në vitin 2004 mori 362 milionë dollarë (OECD). Donatorët shumëpalësh janë burimi kryesor i ndihmës nga jashtë, duke ofruar rreth 65 përqind të ndihmës së përgjithshme për Shqipërinë, ku Greqia, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Europian janë tri donatorët kryesorë. BE është dhe do të mbetet një partner ndërkombëtar kritik në kontekstin e ambicieve të Shqipërisë për anëtarësim të plotë në BE.

PJESA III. BASHKËPUNIMI NË TË KALUARËN DHE MËSIMET E NXJERRA

3.1 Si pjesë e përgatitjes së PVPSH 2006-2010, në konsultim me qeverinë dhe partnerë të tjerë PNUD -I ndërmori një vlerësim të detajuar të programit, i cili përfshiu: (a) një anketim të klientëve, (b) një vetë-vlerësim të përfituesve që u përqëndrua mbi përpjekjet për mobilizimin social dhe pjesëmarrjen, (c) një vlerësim të efektivitetit organizativ (d) një vlerësim të kontributit të Kuadrit të Dytë të Bashkëpunimit me Vendin mbi rezultatet e zhvillimit kombëtar, (e) dhe një vlerësim të rezultateve të programit të mjedisit, i cili përfshiu një analizë të pozicionimit strategjik dhe strategjive të partneritetit të PNUD-it. Mësimet e nxjerra nga vlerësimi i detajuar paraqiten me poshtë. Këto mësime u morën parasysh gjatë procesit të formulimit të PVPSH 2006-2010.

3.2 **Operacionalizimi i OZHM-ve - Një trajtim i rëndësishëm për rritjen e efektivitetit të zhvillimit.** Një mësim i rëndësishëm ka qënë identifikimi i rolit të vlefshëm të OZHM-ve si mjet për të rritur efektivitetin e përpjekjeve të PNUD-it, qeverisë si dhe partnerëve të tjerë mbi zhvillimin. Përsa i përket procesit të operacionalizimit të OZHM-ve, PNUD-i ka mbështetur qeverinë në institucionalizimin e raportimit dhe sigurimin e pronësisë kombëtare mbi OZHM-të, si në nivel qëndror ashtu dhë në atë për vendor. OZHM-të janë bërë një pjesë e rëndësishme e jetës së shumë shqiptarëve ashtu si dhe e zyrtarëve qeveritare. OZHM-të kanë lehtësuar zhvillimin e ndërhyrjeve dhe strategjive, të cilat tashmë janë më të orientuara drejt njerëzve si rezultat i mesazhit të thjeshtë që ato sjellin dhe natyrës së tyre afat-gjatë, duke u krijuar mundësi organeve të interesuara me interesa të ndryshme të mblidhen së bashku në një nivel më të lartë konsensusi nga ai që ekzistonte më parë. Një mësim kyç i nxjerrë është nevoja për ta mbështetur vënien në jetë të programeve me polika, në mënyrë që të garantohet arritja e synimeve.

3.3 **Zhvillimi në Bazë Zone.** PNUD-i do të vazhdojë të operacionalizojë programimin e Zhvillimit në Bazë Zone (ZHBZ) si rezultat i suksesit të arritur në zonën e Kukësit. Programet e ZHBZ synojnë të trajtojnë zona gjeografike të vecanta të vendit, të cilat karakterizohen nga një problem i vecantë zhvillimi, nëpërmjet një mënyre trajtimi të integruar, përfshirëse, elastike dhe me pjesëmarrjen e publikut. Në rajonin e Kukësit topografia malore krijon një kurth hapësinor varfërie. Si rezultat u formulua një kuadër ZHBZ, si një mjet zbatimi për Strategjinë Rajonale të Zhvillimit të OZHM për Kukësin, Programin aktual për Minat, Programin e Qeverisjes Për Vendin, Reformën në Mbështetje të Sektorit Social, dhe Nismën Rajonale për Zhvillim për Kukësin. Këto nisma dhe programe u sollën së bashku nëpërmjet premisave të përbashkëta, planifikimit të përbashkët të punës, dhe personelit të përbashkët si dhe përdorimit të burimeve të tjera në mbështetje të një harmonizimi më efikas dhe efektiv të projekteve. Ky koncept do të vazhdojë të përdoret dhe të shtrihet më tej si në Kukës ashtu dhe në zona të tjera të Shqipërisë, ku një mënyrë e tillë trajtimi është praktike dhe e përshtatshme.

3.4 **Kontributi i PNUD-it mbi Rezultatet.** Siç dhe vihet re në Vlerësimin e Programit Për Vendin, PNUD-i ka dhënë kontribut të rëndësishëm në rezultatet kombëtare të zhvillimit gjatë zbatimit të Kuadrit të dytë të Bashkëpunimit me Vendin. Kjo ka ardhur si rezultat i një kombinimi veprimesh të drejtpërdrejta në mbështetje të komunitetit në nivel vendor si dhe ndërhyrjeve më strategjike të cilat kanë për synim zhvillimin e politikave të zhvillimit, forcimin e institucioneve dhe ngritjen e kapaciteteve në nivel qëndror. Në nivel vendor PNUD-i ka dhënë kontributin e tij në rritjen e niveleve të pjesëmarrjes, rritjes së besimit si dhe garantimit të faktit që si nevojat e gruas ashtu dhe ato të burrit trajtohen në strategjitë rajonale të zhvillimit. Një gjetje tjetër e rëndësishme e dalë nga studimi është se projektet me infrastrukturë të mbështetur nga PNUD-i dhe proçesi social janë të lidhura në mënyrë të komplikuar.

3.5 Misioni vlerësues nxorri gjithashtu në pah një vizibilitet më të lartë të PNUD-it që nga koha e vlerësimit të programit të kaluar të vendit në vitin 2001 dhe nxorri në pah se si programi aktual është mbështetur nga ndërhyrje më të përqendruara të kombinuara me përkrahje për OZHM,

rezultate konkrete në terren, zhvillim të partneriteteve efektive, dhe së fundi ndërhyrje strategjike dhe efektive me anë të medias. Misioni doli gjithashtu në përfundimin se rritja e vizibilitetit është shoqëruar me rritjen e respektit për PNUD-in si organizatë, dhe vlerësimin nga shoqëria shqiptare të veprimeve që ai ndërmerr në vend.

3.6 **Kriteret e Zbatimit.** Si rezultat i suksesit dhe mësimeve të nxjerra, PNUD-i do të përdorë një sërë kriteresh dhe udhëzimesh operacionale standarde për të gjitha projektet, programet, dhe nismat e tjera. Këto kritere përfshijnë:

- **Ndikimin dhe Qëndrueshmërinë.** Ndikimi i prekshëm i zhvillimit si rezultat i nismave dhe qëndrueshmëria e tyre janë kriteret kyçe për PNUD-in. Të udhëhequr nga vizioni dhe përparësitë kombëtare, duke përfituar nga përparësitë krahasuese të PNUD-it, projektet dhe programet do të përpiqen të japin rezultate cilësore, të cilat trajtojnë drejtpërdrejtë sfidat me të cilat përballet Shqipëria. Programet do të formulohen, monitorohen dhe vlerësohen duke e pasur qëndrueshmërinë një komponent integral të punës së tyre.
- **Zhvillimin e Kapaciteteve.** Ngritja e kapaciteteve do të vazhdojë të mbetet një element thelbësor i programeve dhe projekteve të PNUD-it. Duke u bazuar në gjetjet e vetë-vlerësimit nga ana e përfituesve, programet dhe projektet do të përdorin, sipas mundësive, një mënyrë trajtimi të unifikuar në lidhje me ngritjen e kapaciteteve, duke u përqëndruar në ndikimin afatgjatë të trajnimit dhe në përpjekje të tjera për zhvillimin e kapaciteteve lidhur me efektivitetin dhe efiçiencën organizative. Rezultati përfundimtar i një zhvillimi të tillë të kapaciteteve do të jetë përforcimi i pronësisë kombëtare gjatë proçeseve të zhvillimit dhe sigurimi i jetëgjatësisë së rezultateve të projektit.
- **Qasje me Bazë të Drejtat e Njeriut:** Në përputhje me mandatin e KB-së për të përkrahur të drejtat e njeriut dhe duke njohur angazhimin e fortë të qeverisë për të arritur në mënyrë progresive të drejtat e mishëruara në Kushtetutën e Shqipërisë dhe konventat e traktatet e firmosura nga vendi, PNUD-i do të vazhdojë të përdorë në PVPSH 2006-2010 një mënyrë trajtimi me bazë të drejtat e njeriut. PNUD-i do ta zbatojë këtë mënyrë trajtimi në programet e tij: 1) duke ndihmuar zyrtarët qeveritarë të mbrojnë të drejtat e qytetarëve shqiptarë; 2) duke krijuar një mjedis, i cili mundëson arritjen e këtyre të drejtave; dhe 3) duke forcuar kapacitetin e qytetarëve shqiptarë për të ushtruar të drejtat e tyre.
- **Vizibilitet dhe Ndërgjegjësim.** Duke njohur rëndësinë e përpjekjeve për vizibilitet dhe ndërgjegjësim, PNUD-i në Shqipëri do të vërë në jetë një strategji komunikimi që synon një sërë institucionesh të interesuara si brenda dhe jashtë. Midis të tjerash, PNUD-i do të garantojë që kontributet nga ana e organeve të qeverisë, donatorëve dhe partnerëve zbatues si dhe të gjithë partnerëve të tjerë të vihen në dukje në çdo ngjarje publike, si dhe në materialet për shtypin dhe atë të publicitetit.
- **Njohuri nga Jashtë Vendit.** Në mbështetje të objektivit kombëtar për nxitjen e "thithjes se trurit", PNUD-i do të kërkojë të përdorë njohuritë dhe aftësitë e të gjithë shqiptarëve jashtë vendit në të gjithë aspektet e punës së tij. PNUD-i do të nisë një projekt për të regjistruar dhe emëruar në vende pune, shqiptarë që jetojnë jashtë vendit në përputhje me nevojat e sektorit publik dhe privat si dhe botës akademike në një afat të mesëm e të gjatë, si dhe do të përdorë teknologjitë e informimit dhe komunikimit për t'u lidhur me komunitetin shqiptar jashtë atdheut.
- **Mënyra e Koordinuar e Trajtimit.** Të gjitha nismat e PNUD-it do të zbatohen në koordinim me autoritetet përkatëse qeveritare, donatorët, dhe partnerët e tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. PNUD-i do të mbështesë KM-në në ndërmarrjen e një roli udhëheqës në koordinimin e nismave të zhvillimit, sidomos në përputhje me SPI-në.

PJESA IV. PROGRAMI I PROPOZUAR

4.1 Kuadri i Dytë i Bashkëpunimit me Vendin (2002-2005) trajtoi kalimin nga faza e krizës në stabilitet. PVPSH 2006-2010 do të çojë më tej këto themele të forta dhe do të mbështetet mbi KNZHKB (2006-2010). Kjo do të mundësojë një rritje të shkallës së ndryshimeve nëpërmjet përdorimit të mekanizmave dhe modaliteteve për të ulur peshën e mbështetjes ndërkombëtare mbi qeverinë dhe për të rritur efektivitetin e zhvillimit. Së bashku me agjensitë e tjera të KB-së, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri si dhe partnerët e tjerë, ndërhyrjet e PNUD-it do të kontribuojnë në një qeveri më efektive në nivel qendror dhe vendor duke zhvilluar politika dhe programe me pjesëmarrje të gjërë, të cilat do të kontribuojnë në arritjen e OZHM-ve dhe hyrjen në BE.

4.2 Proçesi konsultativ që u përdor për të pergatitur këtë PVPSH 2006-2010 buron nga trajtimi me bazë pjesëmarrjen e publikut në përgatitjen e Vlerësimit të Përbashkët të Vendit (VPV) dhe KNZHKB. Në konsultime të gjëra me qeverinë, OJQ shqiptare dhe të huaja,institucione dhe organizata të tjera të interesuara, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në vend, sistemi i KB-së në Shqipëri përgatiti një VPV të dytë në vitin 2004 për të identifikuar fushat me përparësi kombëtare për një ndihmë të përbashkët për zhvillim nga KB-ja. Proçesi i formulimit të VPV-së përfshiu përdorimin e shtatë Grupeve Tematike, të modeluara si grupet e punës për OZHM-të (varfëria, arsimimi, shëndeti, gjinia, mjedisi, qeverisja dhe partneriteti), të cilat janë përfshirë në përshtatjen e OZHM-ve sipas kushteve të Shqipërisë. Këto grupe tematike u zgjeruan dhe më tej me pjesëmarrjen e gjërë të përfaqësuesve të agjensive të KB-së në Shqipëri (duke përfshirë agjensi që e zhvillojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri dhe jashtë saj), përfaqësuesve të qeverisë, shoqërisë civile, medias, rinisë si dhe të përfaqësuesve të tjerë për të siguruar lidhjen me përparësitë dhe politikat përkatëse të qeverisë dhe institucioneve apo organizatave të tjera të interesuara. Grupet tematike ofruan një analizë të OZHM-ve dhe vunë në dukje një mospërputhje përsa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me të ardhurat, gjininë, moshën dhe hapësirën, të cilat si rezultat u përdorën si tema për t'u trajtuar nga KNZHKB. Duke u bazuar në VPV, u zhvillua një mbledhje për formulimin e KNZHKB që përfshiu një numër të gjërë institucionesh të interesuara. Sic tregohet dhe më poshtë, u identifikuan 4 përfundime të KNZHKB. Dokumenti i PNUD-it për PVPSH 2006-2010 u përpilua në përputhje me formulimin e KNZHKB-së dhe zhvilloi më tej programet në mbështetje të Përfundimeve të PVPSH 2006-2010 në veçanti, si dhe rezultatet/përfundimet e KNZHKB-së.

4.3 Katër përfundimet e PVPSH 2006-2010 si dhe përfundimet përkatëse të KNZHKB-së janë:

i). **Përfundimi 1 i** PVPSH 2006-2010: Kuadër i detajuar i planifikimit të integruar me mekanizmat ekzistuese të reagimit sipas një sistemi menaxhues që udhëhiqet nga rezultatet, si dhe qeverinë dhe administratën publike që i përdorin këto mjete në mënyrë efektive për arritjen e OZHM-së.

Përfundimi përkatës i KNZHKB-së: Një qeveri transparente dhe e përgjegjshme që zhvillon dhe zbaton politika efektive.

ii). **Përfundimi 2 i** PVPSH 2006-2010: Politika të zhvilluara dhe të zbatuara, të cilat mbështesin arritjen e OZHM-ve.

Përfundimi përkatës i KNZHKB-së: Një qeveri transparente dhe e përgjegjshme që zhvillon dhe zbaton politika efektive.

iii). **Përfundimi 3 i** PVPSH 2006-2010: Krijimi i institucioneve dhe forumeve për të mbështetur pjesëmarrjen e publikut - ku përfshihen gjithashtu të rinjtë dhe gratë – nëpërmjet të cilave publikut i jepet mundësia për të marrë pjesë aktive në formulimin e politikave dhe marrjen e vendimeve në të gjitha nivelet.

Përfundimi përkatës i KNZHKB-së: Një mjedis ekzistues, i cili mundëson pjesëmarrjen e publikut në formulimin e politikave dhe marrjen e vendimeve.

iv). **Përfundimi 4 i** PVPSH 2006-2010: Rritja rajonale socialo-ekonomike që përforcohet nëpërmjet zbatimit të decentralizimit fiskal, zhvillimit të sektorit privat, pjesëmarrjes së komunitetit dhe shpërndarjes së përmirësuar të shërbimeve sociale.

Përfundimi përkatës i KNZHKB-së: (i) Strategji rajonale dhe vendore që zbatohen me pjesëmarrjen e plotë të komuniteteve. (ii) Rritje e shkallës së përdorimit të shërbimeve publike cilësore, të cilat ofrohen në një mënyrë efikase, transparente, të përgjegjshme dhe të barabartë.

Në vijim paraqitet një përshkrim i secilit prej Përfundimeve të Programit Për Vendin si dhe nismat e propozuara.

4.4 **Përfundimi 1 i** PVPSH 2006-2010: *"Kuadër i detajuar i planifikimit të integruar me mekanizmat ekzistues të reagimit sipas një sistemi menaxhues që udhëhiqet nga rezultatet dhe qeverinë e administratën publike që i përdorin këto mjete në mënyrë efektive për arritjen e OZHM-ve."* Në mbështetje të këtij përfundimi PNUD-i do të vërë një theks të veçantë mbi mbështetjen për SPI-në që është miratuar kohët e fundit. Përpjekjet kryesore do të përfshijnë çuarjen më tej të funksioneve që kanë të bëjnë me Departamentin e Koordinimit të Strategjive dhe të Donatorëve (DKSD) të ngritur kohët e fundit dhe krijimin e një sistemi funksional të informacionit për SPI-në që identifikon tregues në nivel makro dhe në nivel sektorial të lidhur këta me SKZHES-në dhe ecurinë e OZHM-ve.

Puna do të lidhet me ndihmën aktuale të PNUD-it për Institutin e Statistikave (INSTAT) me qëllimin kryesor dhënie e ndihmës në përmirësimin e kapaciteteve të INSTAT-it për vëzhgimin e arritjes së objektivave të SKZHES-së, OZHM-ve si dhe treguesve të Përfshirjes Sociale të BE-së. Përpjekje do të bëhen për të institucionalizuar bazën e të dhënave të Albinfos që mbështetet tek DevInfo e që shpresohet të jetë online deri në vitin 2006. Puna drejt ngritjes së sistemit Albinfo ka krijuar kushtet për një përmirësim të mëtejshëm të statistikave në Shqipëri. KM-ja dhe PNUD-i do të përpiqen të sigurojnë një cilësi të përmirësuar të të dhënave, dizagregimin e tyre sipas nevojave, qëndrueshmëri dhe besueshmëri, dhe veçanërisht një përdorim më të mirë të të dhënave për përpunimin e politikave dhe kryerjen e vëzhgimit të nevojshëm të proçesit të zhvillimit nëpërmjet një programi të quajtur Shfrytëzimi i të Dhënave për Dialog.

Integrimi i perspektivës së barazisë gjinore në planifikimin e Qeverisë do të trajtohet gjithashtu me përparësi. Është planifikuar një bashkëpunim i ngushtë i vazhdueshëm me Komitetin për Barazi Gjinore. Në rolin e tij si kryetar i koordinimit të donatorëve për problemet e gjinisë, PNUD-i do të ndërmjetësojë gjithashtu një lidhje të ngushtë me Komitetin për Barazi Gjinore, ministritë e linjës, autoritetet vendore dhe shoqërinë civile.

PNUD-i ka një eksperiencë të vlefshme në fushën e mbështetjes së qeverive rajonale dhe planifikimit të zhvillimit rajonal. Kjo është një fushë në të cilën PNUD-i do të ofrojë mbështetje të mëtejshme në të ardhmen si dhe ndërthurje me SPI-në dhe proçesin më të gjërë të reformës në administratën publike. Veç kësaj PNUD-i do të mbështesë përpjekjet rajonale për harmonizimin e objektivave dhe treguesve të strategjive dhe raporteve rajonale me ato të SKZHES, integrimit në BE dhe OZHM-të.

Si një aktor i vendosur tashmë në pilotimin e zgjidhjeve nëpërmjet Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për Zhvillim (TIKZH) në Shqipëri, PNUD-i do të vazhdojë të mbështesë përhapjen më të gjërë të një rrjeti të qeverisë, do të vazhdojë të ofrojë shërbime dhe mjete të reja si dhe të ofrojë trajnim për agjensitë qeveritare pjesëmarrëse. Qëllimi kryesor është të vërë në zbatim një platformë të integruar elektronike të qeverisë brenda kuadrit të trajtimit "nga qeveria te qeveria" sidomos në administrimin e financave publike dhe sistemeve të tjera të menaxhimit. PNUD-i është gjithashtu i gatshëm të përkrahë përdorimin e programeve të hapura apo pa pagesë nga ana e komuniteteve, institucioneve akademike dhe qeveritare si dhe të garantojë akses të barabartë për gratë dhe burrat në këto fusha.

PNUD-i do të vazhdojë të mbështesë zhvillimin e kapaciteteve të Administratës Publike dhe të rrisë kapacitetin e përgjithshëm menaxherial si pjesë e mbështetjes së tij të përgjithshme, e cila synon një qeverisje të mirë në Shqipëri. Duke çuar më tej suksesin e projektit "Mbështetje për trajtimin e 150 menaxherëve në sektorin publik dhe ngritje e kapaciteteve të personelit të ITPA-së", PNUD-i do të nxisë përdorimin e aftësive dhe kompetencave institucionale dhe trajnuese menaxheriale të burimeve të TIPA-së.

Në të gjitha fushat e lartpërmendura, PNUD-i do të bëjë të gjitha përpjekjet për të përdorur ekspertizën e shqiptarëve jashtë vendit. PNUD-i do t'i vijë në ndihmë qeverisë nëpërmjet krijimit të një baze të dhënash për shqiptarët që jetojnë e punojnë jashtë atdheut, të cilët kualifikohen për pjesëmarrje në nismën për "Thithjen e Trurit". Një bazë e tillë të dhënash do t'i vijë në ndihmë qeverisë dhe partnerëve të tjerë si dhe palës ofruese nëpërmjet një listë të individeve të kualifikuar. Si pjesë e kësaj baze të dhënash do të krijohet një faqe interneti ose një rrjet elektronik ndëraktiv për të lidhur Shqipërinë me diasporën shqiptare. Grupet kryesore të fokusit do të jenë: (i) studentët (identifikimi i ish-nxënësve); (ii) diaspora shkencore; dhe (iii) komuniteti i biznesit dhe grupe të tjera të interesuara. PNUD-i do të bashkëpunojë me qeverinë për të mundësuar një fond për "Thithjen e Trurit" me kontribute nga partnerët ndërkombëtarë dhe sektori privat.

4.5 **Përfundimi 2 i** PVPSH 2006-2010: *"Zhvillim dhe zbatim politikash që mbështesin arritjen e OZHM-ve."*
PNUD-i do të mbështesë KM-në, si pjesë e ndihmës së tij për zbatimin e SPI-së, në zhvillimin e një SKZHES-je të bazuar në OZHM-të dhe të lidhur me procesin e integrimit në BE. PNUD-i do të ndihmojë KM-në në zhvillimin e synimeve ambicioze për 2015 brenda kuadrit të vizionit afatgjatë (2030) si dhe do të kombinojë proçesin e formulimit të vizionit me përcaktimin e një numri të ri synimesh ambicioze kombëtare të zhvillimit për vitin 2015. Më në vecanti, PNUD-i do ta mbështesë proçesin duke ndarë eksperiencën e tij në fushat e metodologjisë së vlerësimit të nevojave të OZHM-ve dhe të harmonizimit të treguesve dhe objektivave si dhe të strategjive kombëtare dhe rajonale të zhvillimit në përputhje me planet për integrim në BE. Ekipi i KB-së në Shqipëri do të luajë gjithashtu një rol kyç në ofrimin e informacionit teknik për strategjitë përkatëse sektoriale dhe ndërsektoriale. Në të njëjtën kohë sistemi i KB-së dhe në veçanti agjensitë e specializuara do të kontribuojnë gjithashtu në këtë proçes në bazë të mandateve dhe kompetencave të tyre specifike.

PNUD-i do të vazhdojë të mbështesë KM-në drejt një qeverisje të mirë në trajtimin e cështjeve të ekonomisë informale. Posaçërisht, PNUD-i do ta përqëndrojë ndihmesën e vet drejt studimeve diagnostikuese të sektorit informal dhe këshillimit politik të nivelit të lartë.

Programi i Liberalizimit të Tregtisë, që nisi në qershor 2004, e ka ndihmuar qeverinë për rritjen e aftësive të saj për të vënë në zbatim marrëveshjet që kanë të bëjnë me OBT-në, integrimin në BE si dhe Marrëveshjet Rajonale të Tregtisë së Lirë. PNUD-i do të vazhdojë të ofrojë asistencë praktike për Ministrinë e Ekonomisë Tregëtisë dhe Energjetikës, për të identifikuar investitorë me vlerë të lartë në Itali dhe Gjermani. Ai do të mbështesë gjithashtu zhvillimin e aftësive dhe programeve në mbështetje të sektorit privat në mënyrë që të modernizohen proçedurat e eksportit. PNUD-i do të vazhdojë të bashkëpunojë gjithashtu me Departamentin e Politikave të Ministrisë së Ekonomisë Tregëtisë dhe Energjetikës (METE) në fusha të tilla si Programi për Zëvendësimin e Importeve dhe Financat për Eksportin.

Sa i përket potencialit tregtar dhe eksportues, projekti i Ndihmës në Tregtinë e Bagëtisë (NTB) do të zgjerohet, bazuar në ndihmën e mëparshme që PNUD-i ka afruar në kuadrin e projektit për Forcimin e Marketingut të Bagëtive të Imta. Projekti i NTB-së do të ndihmojë institucionet dhe prodhuesit e sektorit të tregtimit të bagëtisë për të përmirësuar standartet e sigurisë dhe cilësinë e prodhimeve shqiptare. Aktivitetet që do të ndërmerren në këtë drejtim përfshijnë krijimin e një Shoqate shqiptare të Tregtimit të Bagëtisë, ngritjen e sistemit të të dhënave për prejardhjen e

produkteve të mishit dhe sistemit të etiketimit të tyre, si dhe futjen e normave dhe standarteve të BE-së për çertifikimin e prodhimit.
PNUD-i do të vazhdojë të mbështesë qeverinë Shqiptare në zbatimin e konventave kryesore (KDB, KKBLKSH, KKKBNK) për të siguruar qëndrueshmëri mjedisore. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet rritjes së efektshmërisë së angazhimeve ndaj konventave në planet kombëtare të veprimit dhe strategjitë ekzistuese dhe të planifikuara. Mbështetja e vazhdueshme për Vetë-vlerësimin e Kapacitetit Kombëtar kundrejt konventave kryesore do t'i krijojë mundësi vendit të identifikojë boshllëqet në zbatimin e konventave mjedisore dhe të zgjerojnë më tej mbështetjen e Fondit Global Mjedisor (FGM) për Shqipërinë.
Nëpërmjet fondeve të siguruara nga FGM-ja, PNUD-i do të mbështesë përpjekjet kombëtare për të luftuar rreziqet e ardhura si pasojë e ndryshimit të temperaturës. Kjo do të arrihet nëpërmjet përkrahjes për efiçencë të përmirësuar të energjisë në sistemet e ngrohjes dhe furnizimit me ujë dhe rritjes së shkallës së përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Mbështetja për ngritjen e kapaciteteve kombëtare për t'iu përshtatur dhe përgjigjur ndikimeve që vijnë si pasojë e ndryshimit të klimës do të ofrohet si pjesë e mbështetjes për përgatitjen e Komunikimit të Dytë Kombëtar ndaj KKKBNK-ve. Do të punohet gjithashtu drejt ngritjes së kapaciteteve për përgatitjen dhe zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën ndaj Shkretimit dhe Degradimit të Tokave si në nivel kombëtar ashtu dhe në atë vendor. PNUD-i do të ndihmojë Qeverinë Shqiptare në finalizimin e planit të saj kombëtar të veprimit si dhe do të mobilizojë fonde nga FGM-ja për të ngritur kapacitete kombëtare të cilat do të zbatojnë dhe raportojnë mbi angazhimet ndaj KKBLKSH-së.
Duke çuar më tej suksesin e arritur me FGM-në, PNUD-i do të vazhdojë të mbështesë përpjekjet kombëtare dhe rajonale për mbrojtjen e burimeve të rëndësishme të diversitetit biologjik. Kjo do të arrihet nëpërmjet përkrahjes së menaxhimit të integruar të tokave të lagështa dhe menaxhimit të rezervuarëve të ujit. Duke patur parasysh rëndësinë e pyjeve, ruajtjen e biodiversitetit dhe zbutjen e ndikimeve të ndryshimit të klimës, PNUD-i do të mbështesë gjithashtu përpjekjet e vendit për ripyllëzim. Këto ndërhyrje do të forcojnë kapacitetet institucionale dhe njerëzore në nivel qëndror dhe vendor për të zhvilluar dhe zbatuar në vend trajtime të pranueshme të menaxhimit të burimeve natyrore, të cilat do të garantojnë ruajtjen e biodiversitetit dhe ekosistemit në tërësi. PNUD-i do t'i vijë në ndihmë qeverisë në trajtimin e problemeve të përhapura të Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm (NOQ) si dhe të pikave të nxehta mjedisore. Inventari i vazhdueshëm kombëtar i NOQ-it do t'i krijojë mundësinë vendit të zhvillojë një Plan Zbatimi Kombëtar për mbajtjen nën kontroll të NOQ-it.
Duke çuar më tej fushat e lartpërmendura të aktivitetit dhe duke e njohur ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si një faktor kritik për rritjen ekonomike nëpërmjet turizmit, PNUD-i do t'i vijë në ndihmë qeverisë në formulimin dhe zbatimin e zhvillimit kulturor dhe atë me bazë natyrore. Ky zhvillim mbështet strategjinë e vendit për zhvillimin e turizmit mbi të cilin qëndrueshmëria dhe rritja e shkallës së ndërgjegjësimit në lidhje me cështjet mjedisore luajnë një rol të rëndësishëm.
Përpjekjet e PNUD-it do të përqëndrohen në përfshirjen në mënyrë efektive të çështjeve që kanë të bëjnë me gjininë në axhendën kombëtare të zhvillimit dhe formulimit të legjislacionit kombëtar më të ndjeshëm ndaj cështjeve gjinore. PNUD-i do të mbështesë qeverinë në zbatimin e Konventës për Zhdukjen e të Gjitha Llojeve të Diskriminimit ndaj Grave (KZHDG) dhe Platformës së Veprimit të Pekinit si dhe të ligjit shqiptar mbi barazinë gjinore. Mbështetja nga Komiteti për Barazi Gjinore do të përqëndrohet mbi ngritjen e strukturave të qëndrueshme për zbatimin e ligjit mbi barazinë gjinore, mbi një vizibilitet më të lartë dhe kapacitet të përforcuar të komitetit për të mbështetur qeverinë në analizat gjinore, integrimin dhe përkrahjen e forcimit të mundësive sociale, ekonomike dhe politike për gratë.

Do të vazhdojnë më tej aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve në mbeshtetje të ministrive të linjës si dhe pushtetit vendor për integrimin gjinor gjatë proçesit të formulimit të politikave si një mjet për arritjen e OZHM-ve. PNUD-i do të mbështesë edukimin mbi barazinë gjinore, studimet e besueshme mbi politikat, përkrahjen mbi bazë faktesh si dhe rritjen e shkallës së informimit në këtë fushë.

Në mbështetje të nismës "Dekada e Perfshirjes së Romëve", PNUD-i do të përkrahë integrimin e çështjeve që kanë të bëjnë me minoritetet në axhendën e zhvillimit rajonal dhe kombëtar dhe brenda mundësive do të ofrojë mbështetje për strukturat qeveritare, të cilat janë përgjegjëse për çështjet e minoriteteve dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Romët. Do të bëhen gjithashtu përpjekje për të organizuar aktivitete të veçanta për ngritjen e kapaciteteve, të cilat do t'u garantojnë organeve qeveritare mundësinë për të përkrahur, planifikuar dhe të cuar më tej të drejtat e komunitetit.

4.6 **Përfundimi 3 i** PVPSH 2006-2010: *"Krijimi i institucioneve dhe forumeve për të mbështetur pjesëmarrjen e publikut - ku përfshihen gjithashtu të rinjtë dhe gratë - nëpërmjet të cilave publikut i jepet mundësia për të marrë pjesë aktive në formulimin e politikave dhe marrjen e vendimeve në të gjitha nivelet".* PNUD-i do të vazhdojë të japë kontributin e tij në zhvillimin e kapaciteteve, vecanërisht në fushën e pjesëmarrjes së publikut në formulimin e politikave dhe procesin e vendim-marrjes në të gjitha nivelet (vendore, rajonale dhe kombëtare). Këto përpjekje do të synojnë OJQ-të, organizatat e shoqërisë civile, organizatat me bazë komuniteti, grupet e të rinjve dhe grave, median dhe pushtetin vendor. Kjo është një fushë relativisht e re e zhvillimit të tre kapaciteteve që u krijon njerëzve mundësinë për të qënë qytetare aktivë, por që gjithashtu nxit qeverinë në nivelin vendor, rajonal dhe qëndror për të qënë transparente dhe e përgjegjshme; në të njëjtën kohë këto përpjekje për zhvillimin e kapaciteteve krijojnë një mjedis, i cili i krijon mundësinë publikut për të shprehur shqetësimet e tij dhe për t'u përfshirë në planet e zhvillimit.

Një vlerësim i nevojave për përmirësimin e kapaciteteve do të ndërmerret për OJQ-të, OSHC-të dhe organizatat me bazë në komunitet në mënyrë që të trajtohen më mirë nevojat e tyre për të mësuar dhe për të trajtuar boshllëqet lidhur me konceptet e zhvillimit dhe monitorimit. Vlerësimi i kapaciteteve do të përqëndrohet si në nivelin organizativ (në përputhje me mandatin e organizatës), ashtu edhe në nivelin individual (në përputhje me nevojat specifike të individit). Përveç vlerësimit të aftësive, do të kryhet edhe monitorimi i progresit në zhvillimin e aftësive dhe pjesëmarrjen qytetare; do të përcaktohen tregues që do të masin ndikimin dhe rolin e publikut në hartimin e politikave sociale në përputhje me nevojat dhe përparësitë e komunitetit.

PNUD-i do të japë kontributin e tij në ngritjen e institucioneve dhe forumeve, të cilat do të mbështesin një pjesëmarrje të publikut dhe do të garantojnë përfshirjen e gjithanshme të grave, të të rinjve dhe grupeve të pafavorizuara të minoriteteve. PNUD-i do të vazhdojë të përkrahë kapacitetet e OSHC-ve për të ngritur rrjete dhe koalicione përfshirëse në nivel vendor, rajonal, dhe qëndror, të cilat mund të ndikojnë në mënyrë efektive mbi proçesin e formulimit të politikave dhe që do të mundësojnë arritjen e OZHM-ve.

Media do të vazhdojë të mbetet pjesë e synimeve të projekteve të ndryshme të Programit të ri të PNUD-it për vendin, duke qënë një mjet i rëndësishëm në komunikimin për zhvillim, një mjet kyç për debat e përkrahje dhe duke luajtur një rol të pazëvendësueshëm në luftën kundër varfërisë. Shoqëria shqiptare vazhdon të mbetet një shoqëri e politizuar dhe e polarizuar me çështje që kanë të bëjnë me politikën, e cila mbizotëron në debatin e mediave. Një mbulim më profesional i çështjeve sociale do te përmirësojë debatin në vënd dhe do ta drejtojë atë drejt problemeve sociale aktuale me të cilat përballet shoqëria. Duke patur parasysh sa më sipër, PNUD-i do t'i kushtojë një vëmendje të veçantë trajnimit të medias si në kryeqytet ashtu dhe rajonet e tjera të Shqipërisë për një raportim të

përgjegjshëm të zhvillimit njerëzor, të të drejtave të njeriut, çështjeve të minoritetit, barazisë gjinore si dhe për një gazetari që është në kërkim të përgjigjeve. Më tej, parimet e përgjegjësive sociale të përbashkëta do të mbrohen në një diskutim me forume të ndryshme të mediave kombëtare, në mënyrë që të rritet shkalla e tyre e të kuptuarit të problemeve si dhe shkalla e raportimit profesional të tyrë. Këto trajnime do të kenë objektiva specifike të tilla si: ngritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të medias në lidhje me raportimin qytetar, duke trajtuar më shpesh dhe më gjerësisht problemet me të cilat përballen komunitetet në nivel vendor; rritjen e masës së mbulimit të problemeve sociale nga mediat në nivel vendor, nëpërmjet trajnimit të gazetarëve; informimin më të mirë të publikut në lidhje me programin e OZHM-ve në vend; ndikimin mbi politikë-bërësit për kthimin e OZHM-ve në një përparësi për strategjitë rajonale dhe kombëtare të zhvillimit.
Mënyra të reja trajtimi do të përdoren në përpjekjet e përgjithshme për të rritur shkallën e pjesëmarrjes së publikut, ndërtimin e aftësive të tyre per t'u përfshirë në proçesin e vendim-marrjes si dhe në përpunimin e aftësive krijuese menaxhuese tek drejtuesit e komuniteteve, aktivistët e shoqërisë civile, anëtaret e OJQ-ve dhe zyrtare të pushtetit vendor. Në këtë mënyrë ata do të bëhen drejtues të aftë për të përballuar sfidat e reja të zhvillimit në komunitetet e tyre dhe do të çojnë më tej rritjen e shkallës së bashkëpunimit në nivel vendor, në mënyrë që axhenda e zhvillimit të përfshijë pushtetin vendor, shoqërinë civile dhe komunitetin e biznesit dhe të gjithë partnerët që kontribojnë në arritjen e qellimeve të përbashkëta.
PNUD-i do të përkrahë format e reja të dialogut ndërmjet shoqërisë civile dhe qeverisë qëndrore dhe vendore me qëllim që të rrisë shkallën e përgjegjshmërisë dhe të transparencës së pushtetit vendor si dhe të përkrahë moritorimin pjesëmarrës të zbatimit të SKZHES-së dhe strategjive rajonale. Rritja e shkallës së disponueshmërisë dhe cilësisë së të dhënave do të përkrahet brenda kuadrit të programit "Shfrytëzim i të Dhënave për Dialog", i cili do të përdorë teknologjitë e informacionit për të bërë të mundur një pjesëmarrje më efektive dhe më të informuar.
Ky element do te mbështetet mbi mësimet e nxjerra nga tre ndërhyrjet e mëparshme: (i) krijimi i Qëndrave të Aksesit të Publikut (QAP) (ii) përpjekjet e vazhdueshme për të krijuar një version vendor të DevInfos (të quajtur AlbInfo) për INSTAT-in dhe autoritetet e tjera qëndrore dhe vendore, dhe (iii) përkrahja e përpjekjeve të përgjithshme për të bërë të mundur ndarjen dhe shkëmbimin më të mirë të të dhënave dhe informacionit ndërmjet qeverisë dhe publikut të gjërë, nëpërmjet një infrastrukture të fortë elektronike (GovNet) si dhe sistemeve të informacionit dhe aplikimeve.
PNUD-i do të vazhdojë t'i japë shtysë përdorimit të TIK-ut si një mjet për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në formulimin e politikave, monitorimin dhe vlerësimin, dhe proceset e tjera të zhvillimit në nivel vendor dhe qëndror. Aksesi i barabartë për gratë, të rinjtë dhe komunitetet rurale do të përkrahet si aspekti bazë për pjesëmarrjen nëpërmjet TIK. Më tej, lehtësirat e TIK-ut do të përdoren për të nxitur planifikimin e burimeve, për të krijuar një rrjet njohurish mbi zhvillimin e administratave vendore dhe për të përmirësuar aftësitë teknike të autoriteteve për të përdorur TIK-un si për veprimtari efektive të brendshme ashtu dhe për komunikim me qytetarët, komunitetin donator ndërkombëtar dhe atë të biznesit. Një rrjet i tillë do të rrisë kapacitetet e institucioneve të përfshira në proces për të krijuar mundësi për një pjesëmarrje më efektive në proçesin e qeverisjes. Rritja e transparencës në nivel vendor do të mbështesë përpjekjet në shkallë më të gjërë nga ana e qeverisë për të luftuar korrupsionin dhe veprimtaritë e jashtëligjshme.
Përveç kësaj, PNUD-i do të përdorë bazën e ekspertizës dhe njohurive të TIK-ut në përparësinë e tij për të pajisur shkollat fillore dhe të mesme në Shqipëri me lidhje interneti, duke garantuar kështu që të rinjtë të përfitojnë aftësitë e nevojshme TIK për të marrë pjesë në proçeset politike. Objektiva plotësuese në mbështetje të këtij qëllimi

përfshijnë: i) trajnimin e mësuesve; ii) zhvillimin e programit mësimor; iii) prezantimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit në Arsim (SMIA) në sistemin arsimor publik; (iv) kompjuterizimin e shkollave. Është rënë dakort ndërmjet KM-së dhe PNUD-it që shkollat do të përdoren si teleqendra/Qendra të Aksesit Publik (QAP) për komunat dhe nismat do të zbatohen si bashkëpunime ndërmjet institucioneve arsimore, qeverisë, forumeve akademike, biznesit, shoqërisë civile, medias dhe donatorëve. PNUD-i do të vazhdojë të ofrojë mbështetje për zbatimin e masterplanit qeveritar në bashkëpunim me aktorët e tjerë të interesuar dhe publikun. Të gjitha përpjekjet e përmenduara më sipër do të lidhen me aktivitetet dhe nismat e mobilizimit shoqëror në mbështetje të një përgjegjshmërie më të lartë nga ana e qeverisë në programet e ndërmarra.

Do të bëhen përpjekje të veçanta për të mbështetur arsimin qytetar dhe nxitjen e vullnetarizmit. Këto përpjekje do të lidhen me aktivitetet dhe nismat e mobilizimit shoqëror në mbështetje të një përgjegjshmërie më të lartë nga ana e qeverisë në programet e ndërmarra. Duke e njohur vullnetarizmin si një element të rëndësishëm në qeverisjen efektive dhe zhvillimin e suksesshëm social dhe ekonomik, PNUD-i do të mbështesë proçeset e decentralizimit, të cilat nxisin qeverisjen vendore me pjesëmarrjen e publikut dhe u krijojnë mundësi komuniteteve, nëpërmjet përfshirjes në një numër të madh nismash për një qeverisje të mirë. Në ndërthurje me këtë, do të vihet një theks mbi forcimin e pushtetit vendor duke mundësuar pjesëmarrjen e komunitetit, duke ngritur kapacitetin e qeverive në nivel bashkie, rrethi dhe krahine dhe duke forcuar shoqërinë civile nëpërmjet ndihmës ndaj organizatave vendore dhe grupeve të synuara të tilla si: gratë dhe të rinjtë. Duke njohur rolin që të rinjtë luajnë mbi zhvillimin në shoqëritë ku ata jetojnë dhe nevojën për ta shfrytëzuar këtë potencial, PNUD-i dhe programi i tij i Vullnetarëve [të KB-së] do të studiojnë mënyrat në të cilat të rinjtë mund të mobilizohen dhe të përfshihen në aktivitete në nivel komuniteti, rajonal dhe kombëtar, duke nxitur dhe duke çuar më tej kulturën e vullnetarizmit.

4.7 **Përfundimi 4** i PVPSH 2006-2010: *"Përmirësimi në rajon i rritjes socialo-ekonomike nëpërmjet decentralizimit fiskal, zhvillimit të sektorit privat, pjesëmarrjes së komunitetit dhe shpërndarjes së përmirësuar të shërbimeve publike"*. PNUD-i do të vazhdojë dhe do të rrisë më tej mbështetjen dhe ndihmën e tij në fushën e reformës së decentralizimit dhe forcimit të qeverisjes vendore, duke u bazuar në suksesin dhe rezultatet e ciklit të programeve të mëparshme dhe, veçanërisht, në pozicionin udhëheqës që ka fituar nëpërmjet programeve të Qeverisjes Vendore, Mbështetjes në Sektorin e Sigurisë, Aksionit për Minat dhe pranisë së gjërë gjeografike në vend.

Në fushën e reformës së decentralizimit dhe mbështetjes së qeverisjes vendore, PNUD-i do të çojë më tej dhe do të forcojë suksesin e Programit ekzistues për Qeverisjen Vendore (PQV). PQV-ja do të vazhdojë të përqëndrojë ndërhyrjet në të gjitha nivelet e qeverisjes, të cilat ndikojnë në zhvillimin vendor - të cilat variojnë nga niveli qëndror në nivel vendor dhe nga bashkitë në komuna, e gërshetuar kjo me një nxitje të fuqishme të bashkëpunimit midis organizmave të mësipërme administrative me shoqërinë civile në nivel vendor, sektorin privat dhe vetë komunitetet. PNUD-i do të përkrahë sidomos një mjedis që mundëson rritjen e zhvillimit rajonal, i cili përputhet dhe reflekton përparësitë për Vendin, dhe që është gjithashtu në përputhje me SKZHES-në dhe OZHM-të si dhe politikat dhe instrumentet e zhvillimit rajonal të BE-së. PQV-ja do të ofrojë mbështetje të drejpërdrejtë në zhvillimin e ekonomive vendore dhe infrastrukturën sociale brënda kuadrit të nxitjes së zbatimit të Strategjisë Rajonale për Zhvillim, duke përfshirë aktivitete që synojnë të sigurojnë shpërndarjen e shërbimeve bazë dhe lehtësimin e zhvillimit të SME-ve, nismat ndërkufitare dhe inkubatorët e biznesit. Theksi do të vihet mbi ekonomitë

vendore dhe infrastrukturën sociale që trajtojnë pabarazinë gjinore dhe nevojat e vecanta të grave dhe të rinjve në këto fusha. Ky proces do ta përgatisë vendin dhe pushtetin vendor për maksimalizimin e përfitimeve dhe mundësive të krijuara nga fondet rajonale strukturale të ardhshme të BE-së, të cilat do të mundësohen në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asociimit.

PQV-ja do të vazhdojë gjithashtu të funksionojë si një program ombrellë për një spektër të gjërë aktivitetesh të tjera që kanë të bëjnë me zhvillimin rajonal dhe vendor. Fusha e interesit të PQV - së variojnë nga zhvillimi apo ruajtja e traditës kulturore, mjedisi, nismat ekonomike vendore për zhvillim deri tek forcimi i sektorit privat vendas dhe përfaqësimi dhe pjesëmarrja e komunitetit në zhvillimin e politikave dhe në nxitjen e barazisë gjinore. Një theks i mëtejshëm do të vihet mbi nismën për të zhvilluar infrastrukturën dhe planifikimin në zonat që janë më shumë të populluara nga minoritetet rome dhe egjiptiane.

Një vëmendje dhe mbështetje e veçantë do t'i jepet ngritjes së kapaciteteve në nivel rajonal, bashkie dhe komune duke theksuar në veçanti forcimin e kapaciteteve të menaxhimit financiar të këshillave rajonale, paralelisht me zhvillimin e aftësive, njohurive dhe kapaciteteve që i vijnë në ndihmë pushtetit vendor për të vendosur përparësitë, planifikuar, menaxhuar dhe mbikqyrur zhvillimin në një mënyrë efikase dhe përfshirëse. Këto mekanizma do të përpiqen të përkrahin një qëndrim të bashkuar të donatorëve të ndryshëm dhe organizatave të tjera që mbështesin përpjekje të ngjashme në vend, me qëllim harmonizimin dhe uljen e kostove të transaksioneve për përfituesit. PNUD-i do të vazhdojë të mbështesë gjithashtu pushtetin vendor në integrimin gjinor në strategjitë e zhvillimit rajonal, planet dhe raportet në nivel komune dhe bashkie, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve dhe mbështetjes praktike.

Në fushën e Reformës së Sigurisë, PNUD-i do të vazhdojë të mbështesë policinë shqiptare në nivel qëndror dhe atë në nivel vendor si dhe komunitetet vendore në prefekturat e përzgjedhura të vendit për përkrahjen e parimeve të ruajtjes së sigurisë në bazë komuniteti, do të mbështesë bashkëpunimin ndërmjet policisë në nivel vendor dhe komuniteteve, një imazh te përmirësuar të policisë dhe shërbimeve ndaj publikut me qëllimin që të mundësojë parandalimin e krimit dhe zgjidhjen e konfliktit si dhe të forcojë kohezionin social dhe besimin e publikut tek institucionet shtetërore. Një mbështetje e veçantë do të jepet për përmirësimin e mjediseve ku ushtron aktivitetin e saj policia dhe projektet e komunitetit që kanë të bëjnë me krijimin e një mjedisi më të sigurtë, aktivitetet për të lehtësuar trajnime të veçanta për policinë dhe institucionalizimin e një dialogu ndërmjet policisë dhe studentëvë në sistemin e arsimit në të gjitha fushat e programeve. Mbështetje do t'i jepet edhe krijimit të partneriteteve duke angazhuar grupet e komuniteteve për zgjidhjen e problemeve dhe policinë në trajtimin e dhunës në familje.

Në fushën e Aksionit të Minave, PNUD-i është plotësisht i angazhuar dhe i përgatitur që të vazhdojë të japë një ndihmë të përgjithshme në vend për të pastruar zonën veri-lindore nga minat dhe municioni i pashpërthyer (MP) i mbetur nga konflikti në Kosovë i vitit 1999. PNUD-i ka krijuar një pozicion të fuqishëm udhëheqës në këtë fushë dhe në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me autoritetet qeveritare dhe komunitetin ndërkombëtar, jep një ndihmë të drejtpërdrejtë për ngritjen e kapacitetit kombëtar të zyrës së Aksionit kundër Minave dhe zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimeve për Aksionin kundër Minave.

Në këtë kuadër, ndihma e PNUD-it gjatë ciklit të ri të programit do të përqendrohet në fushat kryesore të mëposhtme: (i) ndihma për pastrimin e zonave që janë prekur shumë apo në masë mesatare me synimin që ky objektiv të përmbushet deri në fund të vitit 2006 si dhe të punohet në zonat që janë pak të prekura deri në fund të vitit 2009, (ii) krijimi i Kapacitetit Kombëtar të Pastrimit brenda fundit të vitit 2006 në mënyrë që ky i fundit të marrë përgjegjësinë për pastrimin e minave në vend nga viti 2007 e tutje, (iii) përgatitja e terrenit dhe kalimi i strukturës së AkM tek qeveria, strukturë e cila do të bëhet pjesë e administratës publike që nga fillimi i vitit 2007, (iv)

koordinimi i aktiviteteve për Edukimin mbi Rrezikun nga Minat në terren dhe ndihma ndaj autoriteteve kombëtare përkatëse - në bashkëpunim me UNICEF - duke përfshirë temën e ndërgjegjësimit ndaj minave/armëve në programet shkollore që do të përshtaten në mënyrë progresive në të gjithë vendin, dhe (v) forcimi i kapacitetit kombëtar për Ndihmën ndaj Viktimave deri në fund të vitit 2006 në mënyrë që ky i fundit t'u japë ndihmë mjekësore, fizike, sociale dhe ekonomike të mbijetuarve nga aksidentet e minave/municionit të pashpërthyer dhe familjeve të tyre - në veçanti grave të cilat kanë përgjegjësi më të mëdha për mbajtjen e familjeve si rezultat i plagosjeve apo vdekjes së anëtarevë meshkuj të familjes.

Pjesa V. STRATEGJIA E PARTNERITETIT

5.1 Për t'u siguruar që PVPSH 2006-2010 është i sinkronizuar me programet e partnerëve të tjerë që punojnë për zhvillimin dhe për t'u siguruar që ekzistojnë burime të mjaftueshme për zbatim, PNUD-i do ta vërë në jetë PVPSH 2006-2010 nën drejtimin e KM-së dhe mbi bazë të një strategjie partneriteti gjithpërfshirëse që synon t'u jap shtysë vlerave dhe kapaciteteve njerëzore, financiare dhe teknikë.

5.2 Partneri kryesor strategjik i PNUD-it - si agjensia e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - do të jetë KM-ja. PNUD-i do të punojë gjithashtu në bashkëpunim të ngushtë me agjencitë e tjera të KB-së, organizatat, institucionet, fondacionet, misionet si dhe kompanitë që janë angazhuar në objektivat që janë parashtruar në KNZHKB-në si dhe në zbatimin efikas të PVPSH 2006-2010.

5.3 Duke përdorur pozicionin e tij unikal, si një organizatë elastike dhe e paanshme, që mbulon gjithë vendin dhe që është konsekuente me mandatin e saj për të mbështetur përpjekjet bashkëpunuese, PNUD-i do të vazhdojë të përforcojë dhe të zgjerojë bashkëpunimet sociale duke ndihmuar në krijimin e lidhjeve ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile si dhe do të përkrahë bashkëpunimin me bizneset e medha kombëtare dhë ndërkombëtare duke u bazuar mbi parimet e përgjegjësisë sociale dhe partneritetit midis publikut dhe sektorit privat.

5.4 PNUD-i do të vazhdojë të përdorë teknika të reja për të nxitur partneritetet në mënyrë që të garantojë që të gjithë partnerët gëzojnë mundësinë e dialogut dhe ndërveprimit me PNUD-in dhe aktorët e tjere. Do të përdoren metodologji të ndryshme në lidhje me pjesëmarrjen dhe këto do të zgjerohen në nivel vendor aty ku ekziston mundësia.

5.5 Strategjia e Partneritetit të PNUD-it, për vitet 2006-2010 do të zhvillohet më tej për të qartësuar rolin e partnerëve në programe dhe projekte të ndryshme. Llojet e organizatave me të cilat PNUD-i do të hyjë në partneritet dhe roli i tyre i përgjithshëm në këto partneritete janë paraqitur më poshte:

i) **Qeveria Shqiptare.** Kjo përfshin ministritë dhe departamentet e qeverisë, komitetet, komisionet dhe këshillat, organizatat legjislative dhe ekzekutive si dhe gjykatën. Ne veçanti, PNUD-i do të punojë nga afër me KM-në, METE-n, Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave, Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve, Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Integrimit, Zyrën e Presidentit si dhe Parlamentin, përsa i përket drejtimit të përgjithshëm të programit të PNUD-it. Roli i përgjithshëm i organeve të qeverisë qëndron në ofrimin e lidershipit si dhe kontributeve në natyrë apo në para për të mbështetur programin e PNUD-it si dhe bashkëpunimin me PNUD-in për të zbatuar projekte specifike dhe për të monitoruar dhe vlerësuar efikasitetin e këtyre projekteve.

ii). **Agjensitë Donatore.** Këto [agjensi] mund të përfshijnë donatorë dypalesh, donatorë shumëpalesh, fonde globale në besim-marrje, fondacione, etj. Tek donatorët dypalesh mund të

përfshihen vende që kanë mbështetur punën e PNUD-it në Shqipëri në të kaluaren, si Italia, Suedia, Norvegjia, Austria dhe Holanda, ose donatorë jo-tradicionalë që po shfaqen së fundi si Republika Çeke, Slovakia dhe anëtarë të BE-së, të cilët sapo janë anëtarësuar. Tek donatorët shumëpalësh mund të përfshihen Banka Botërore dhe Bashkimi Europian. Do të krijohen partneritete me këta donatorë për të arritur objektiva të përbashkëta; gjithashtu, kanalizimi i burimeve nëpërmjet PNUD-it do të mbështesë perpjekjet për një përdorim më efikas dhe të harmonizuar të ndihmës. Fondet globale në besim-marrje mund të përfshijnë Fondin Global për Mjedisin, Protokollin e Fondeve të Garancisë të Montrealit, ose fondet tematike në besim-marrje (të tilla si ato për Gjininë, Qeverisjen Demokratike, etj.). Fondet në besim-marrje do të jenë ndër instrumentat kyçe në dhënien e burimeve financiare për programet e propozuara.

iii). **Shoqëria Civile.** Organizatat e shoqërisë civile mund të përfshijnë organizata joqeveritare ndërkombëtare, kombëtare apo vendore, shoqata profesionale, unione të punës, sindikata pune, fondacione, etj. PNUD-i do të forcojë partneritetin me organizatat e shoqërisë civile duke përfshirë këtu organizatat joqeveritare, rrjetet dhe forumet e grave. Në disa raste, organizatat e shoqërisë civile do të zbatojnë projekte të PNUD-it. Diaspora shqiptare mbetet një grup kyç që do të angazhohet më tej në programet e PNUD-it, me synim mobilizimin e burimeve për nisma brenda vendit. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet krijimit të lidhjeve me organizata të cilat mbështesin apo merren në mënyrë të drejtpërdrejtë me minoritetet e pafavorizuara.

iv). **Agjensitë dhe Fondi i KB-së.** Në një përpjekje për të punuar në një mënyrë shumë më të haronizuar si një familje e KB-së, PNUD-i do të punojë ngushtësisht me Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), Fondin e Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA), Organizatën Botërore të Shëndetit (ËHO), Organizatën Botërore të Punës (ILO), Vullnetarët e Kombeve të Bashkuara (VKB), Sekretariatin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), Programin e Përbashkët të Kombeve të Bashkuara për HIV/AIDS (UNAIDS), Programin e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP), Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Shkencën, Arsimin dhe Kulturën (UNESCO), Fondin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara për Gratë (UNIFEM), Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), dhe Organizatën Ndërkombëtare të Migracionit (IOM). Ajo që synohet është që agjensitë e KB-ve të punojnë në partneritet me PNUD-in për të zbatuar dhe/ose bashkëfinancuar projekte te përbashkëta të KB-së dhe PNUD-it. Takimet strategjike të përbashëeta (TSP) do të sigurojnë gjithashtu që rezultatet e PVPSH 2006-2010 po kontribuojnë në rezultatet e KNZHKB-së. Për më tepër, TSP do të luajnë rolin e forumeve mbikqyrëse periodike dhe rishikuese të PVPSH 2006-2010.

v) **Media.** Media përfshin si gazetat e vendit ashtu edhe ato të huaja, stacionet e radiove dhe televizioneve, revistat dhe faqet e internetit. Në të gjitha fushat PNUD-i do të bashkëpunojë me median në vend dhe jashtë vendit, në mënyrë që të sigurojë shpërndarjen maksimale të mesazheve të PNUD-it; kjo do te arrihet nëpërmjet dhënies së rregullt të komunikatave për shtyp, nëpërmjet konferencave të shtypit, shpërndarjes së materialeve për informimin e publikut, nëpermjet udhëtimeve të shtypit, si dhe duke dhënë intervista kurdo që të jetë e mundur. Theksi do te vihet gjithashtu mbi forcimin e kapacitetit të medias, per t'u dhënë atyre mundësinë për të kontribuar në mënyrë efikase në procesin e zhvillimit kombëtar.

vi) **Sektori Privat.** Sektori privat përfshin kompani shumëkombëshe dhe vendase që prodhojnë të mira materiale dhe ofrojnë shërbime për publikun në Shqipëri. Të marra së bashku, këto kompani do të jenë mjeti më i rëndësishëm për rritjen ekonomike në këtë ekonomi tranzicioni. PNUD-i do të nxisë një ndërgjegjësim më të madh social dhe një përgjegjësi më të madhe sociale brenda komuniteteve të biznesit. Në disa raste, PNUD-i do të nënkontraktojë firma private të sektorit privat për zbatuar projektet e tij ose per të ofruar shërbimet e tyre këshillimore apo pajisjet e tyre. Në raste të tjera, veçanërisht në rastin e korporatave shumëkombëshe, të cilat

zbatojnë programe të shërbimeve publike, PNUD-i do të zhvillojë programe të përbashkëta për të përmbushur objektivat e perbashketa mbi të cilat është rëne dakort.

vii) **Akademia.** Akademia përbëhet nga universitetet ndërkombëtare dhe kombëtare, institutet kerkimore, institutet studimore, etj. Meqënëse baza për një këshillim të mirë është kërkimi [i thellë], PNUD-i do të angazhojë organizata të tilla për të garantuar kërkime dhe analiza të një cilësie të lartë në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin e Shqipërisë. Për më tepër, PNUi do ta përdorë sektorin e akademisë për shpërndarjen e leksioneve që kanë të bëjnë me zhvillimin njerëzor të qëndrueshëm dhe barazinë gjinore, nëpërmjet ngritjes së institucionevë që do të ofrojnë këto leksione.

Pjesa VI. MENAXHIMI I PROGRAMIT

6.1 PNUD-i do të vazhdojë të përdorë Zbatimin e Drejtpërdrejtë (ZD) si një vegël për manaxhimin dhe zbatimin e programit. Përpjekje do të bëhen për të prezantuar Zbatimin në Shkallë Kombëtare (ZSHK), nëpërmjet ndërhyrjeve të reformes së administratës publike dhe përmirësimit të përgjithshëm të situatës së qeverisjes ne Shqipëri. PNUD-i do të bashkëpunojë ngushtë me KM-në, pushtetin vendor, shoqërinë civile, donatorët dhe grupet e tjera të interesuara, për të siguruar pronësi dhe qëndrueshmëri të ndërhyrjeve se programit. Planet Vjetore te Punes (PVP) dhe/ose dokumentat e projektit përshkruajnë rezultatet specifike që duhet të arrihen. Ky plan do të përbëjë marreveshjen baze ndërmjet PNUD-it dhe partnerëve në lidhje me përdorimin e burimeve.

6.2 Programi i PNUD-it do të mbështesë zbatimin e Deklaratës së Parisit dhe Deklaratave të tjera në mbështetje te një efikasiteti të ndihmës. Programi do të mbështesë një lidhje më të mirë të ndihmës së tij dhe ndihmës së partnerëve te tij ndërkombëtarë me përparesitë kombëtare. Ai do te bëjë përpjekje më të mëdha për të përmirësuar harmonizimin me partnerët e tij dhe me strukturat e qeverisë, dhe për të siguruar pronësi kombëtare efikase të ndërhyrjeve te tij. PNUD-i do te vazhdojë të punoje me Sekretariatin Teknik të Donatorëve për të mbështetur qeverinë në zbatimin e Sistemit te Planifikimit te Integruar (SPI), i cili do të lehtësojë mënyrat e tilla te trajtimit.

6.3 Programi PVPSH 2006-2010 çon më tej parimet e reformës së Kombeve të Bashkuara, veçanërisht thjeshtëzimin dhe harmonizimin, duke vepruar ne bazë të instrumentave të harmonizuara të programimit të vendit të tilla si: PVPSH 2006-2010, Plani Vjetor i Punes (PVP), dhe/ose dokumenta të projektit. PNUD-i dhe partneret e tij do te përdorin brenda mundësive, numrin minimal te dokumentave të kërkuara, PVPSH 2006-2010 dhe PVP dhe /ose dokumente të projektit, për të zbatuar nismat programatike.

6.4 Atlas (softëare i programit dhe mbështetjes së veprimeve të PNUD-it) ndihmon në zhvillimin e aktiviteteve në kohe si dhe në monitorimin efikas financiar për të menaxhuar projektet dhe programin e PNUD-it.

6.5 Ne rastin e projekteve me Zbatim Kombetar (ZK) duhen repsektuar dispozitat 6.5 deri ne 6.11. PNUD-i mund te beje transferta ne para (cash) per aktivitetet e detajuara ne PVP dhe/ose ne dokumentat e projektit - per projektet per Zbatimin ne Shkalle Kombetare (ZSHK), duke perdorur menyrat e meposhtme:

(i). Trasferim i parave (cash) drejtpersedrejti tek Partneri Zbatues (ose tek institucioni kombetar perkates, i cili qe do t'ia kaloje fondet Partnerit Zbatues ne menyre te shpejte).

a). Perpara se te filloje veprimtaria (transferime te drejtperdrejta te parave), ose

b). Mbasi te jene perfunduar aktivitetet (rimbursim);

(ii) Pagese e drejtperdrejte tek shitesit apo palet e treta per te mbuluar detyrime qe kane ardhur nga Partneri Zbatues mbi baze te kerkesave te firmosura nga zyrtaret e caktuar te partnereve zbatues.

(iii) Pagesa te drejtperdrejta shitesve apo paleve te treta per detyrime qe kane ardhur nga agjensite e KB ne mbeshtetje te aktiviteteve te rena dakort me partneret zbatues.

6.6 Transfertat e drejtperdrejta te parave (cash) duhet te jene kerkuar dhe leshuar per periudha te zbatimit te programit ZSHK qe nuk i kalojne 3 muajt. Rimbursimet e shpenzimeve te autorizuara me pare duhet te kerkohen dhe te leshohen kater here ne vit ose pas permbushjes se aktiviteteve. PNUD-i nuk eshte i detyruar te rimbursoje shpenzimete bera nga partneri zbatues mbi shumat e autorizuara.

6.7 Pas perfundimit se cdo lloj aktiviteti, cdo lloj bilanci i fondeve do te riprogramohet bazuar mbi marreveshjet e perbashketa ndermjet Partnerit Zbatues dhe PNUD-it ose do te kthehen vlerat monetare.

6.8 Menyrat e pagesave cash, masa e rimbursimeve, qellimi dhe shpeshtesia e veprimeve te ZSHK per projektet PVP do te varen nga perfundimet e nje rishikimi te kapacitetit te menaxhimit publik financiar ne rastin kur partneri zbatues eshte qeveria, dhe te nje vleresimi te kapacitetit te menaxhimit financiar te partnereve zbatues qe jane te ndryshem nga agjensite e Kombeve te Bashkuara. Nje konsulent i kualifikuar, i tille si nje firme auditimi publike, e perzgjedhur nga PNUD-i do te beje kete vleresim, ne te cilin do te marre pjese edhe Partneri Zbatues.

6.9 Menyrat e transferimit te parave (cash), masa e rimbursimeve, si dhe qellimi dhe shpeshtesia e veprimeve siguruese, mund te rishikohen gjate zbatimit te programit, ne baze te perfundimeve te mbikqyrjes se programit, mbikqyrjes se shpenzimeve dhe raporteve si dhe auditimeve.

6.10 Nen kete program, auditoret do te organizohen si nje pjese integrale e nje menaxhimi te shendoshe financiar dhe administrativ dhe pjese integrale e kuadrit te pergjegjshmerise se PNUD.-it Gjetjet/Vezhgimet e auditimit do te perdoren se bashku me monitorimin, vleresimin dhe raporte te tjera per te permiresuar vazhdimisht cilesine e aktiviteteve dhe cilesine e menaxhimit.

6.11 Rezultatet e vleresimit te kapaciteteve te Partnereve Zbatues do te perdoren per te formuluar vendimet mbi transferimet e burimeve. Perpjekjet per te mobilizuar burimet do te rriten per te mbeshtetur Kuadrin e Rezultateve dhe Burimeve (KRB) dhe per te siguruar qendrueshmeri te programit. Per te plotesuar financimin kryesor dhe per te rritur ndikimin e programeve te tij, PNUD-i do te kerkoje financime paralele, ndarje te kostos dhe burimeve ne natyre me qeverine, donatoret dhe partneret e sektorit privat. Do te behet nje pune aktive dhe do te zbatohet nje strategji per komunikimin per permiresimin e komunikimit me partneret financues. Partneritete te tjera (te reja) do te kerkohen nepermjet nje koordinimi me te mire me aktivitetet e Fondeve Globale Tematike te Besim-marrjes te PNUD-it, Dokumentit te Programit Rajonal (DPR) per Evropen dhe BSHP-ne, dhe Fondit Global per Mjedisin (FGM). Eshte perfshire nje qellim ambicioz per mobilizimin e burimeve duke u bazuar bazuar ne suksesin ne rritje te Zyres se Vendit ne mobilizimin e burimeve nga sektori privat. ZV-te gjithashtu planifikon te perdore mjete dhe menyra te reja per te zgjeruar punen e saj ne kete fushe. Gjate vitit 2006 ne bashkepunim te ngushte me KM-ne dhe me partnere vendas dhe nderkombetare do te zhvillohet nje strategji me e detajuar per mobilizimin e burimeve qe reflekton gjithashtu nje marredhenie te re me sektorin privat. Perpjekje do te behen ne mbeshtetje te Projektit te Mijevjecarit, Konsensusit te Monterrey-t dhe Deklarates se Romes mbi harmonizimin dhe koston e reduktuar te transaksioneve per te ndihmuar vendet donatore te permbushin detyrimet e tyre. Do te studiohen masa te reja te tilla si bashkimi i fondeve te ndihmes teknike si dhe do te respektohen ngushtesisht eksperiencat e rajoneve dhe vendeve te tjera.

Pjesa VII. MONITORIMI DHE VLERESIMI

7.1 Ne mbeshtetje te axhendes se KB-se per refome globale dhe si pjese e perpjekjeve ne vazhdim per te harmonizuar dhe thjeshtezuar perpjekjet e KB-se ne nivel vendi, Monitorimi dhe Vleresimi (M&V) i PVPSH 2006-2010 do te behet ne perputhje me rezultatet e matrices se KNZHKB-se dhe planit te monitorimit dhe vleresimit. Ne bashkepunim me KM-ne dhe partneret e tjere PNUD-it do te jene pergjegjes per vendosjen e mekanizmave dhe mjeteve dhe per rishikimin e nevojshem te M&V, ne menyre qe te sigurohet nje Monitorim dhe Vleresim i vazhdueshem i PVPSH 2006-2010, duke siguruar perdorimin efikas te burimeve te programit si dhe pergjegjesine, transparencen dhe integritetin. Partneret zbatues do te paraqesin raporte periodike mbi ecurine, arritjet dhe rezultatet e projekteve te tyre, duke vene ne pah sfidat me te cilat jane perballur si dhe raporte mbi perdorimin e burimeve sic eshte rene dakort ne PVP-ne dhe/ose dokumentat e projektit. Ne masen me te mundshme raportimi do te behet ne perputhje me procedurat dhe i harmonizuar me agjensite e KB-se.

7.2 Menaxhimi ne baze rezultatesh do te sherbeje si baze per programin e PNUD-it gjate ciklit te ardhshem. Perpjekje do te behen per te forcuar orientimin e rezultatit te ZV vecanerisht ne fushat e ndihmes se bute ku vleresimi efikas i rezultateve eshte me i veshtire. Monitorimi dhe vleresimi i programit do te nje pjese integrale e programit te vendit. Perparesi do t'u jepet vleresimeve tematike/rezultateve te programeve kryesore te PNUD-it ne bashkepunim me agjensite dhe partneret e tjere te KB, duke patur parasysh masen ne te cilen programet trajtojne pabarazine gjinore dhe rajonale si dhe ceshtjet e minoriteteve. Si pjese e kesaj strategjie per te theksuar pronesine kombetare te bashkepunimit te PNUD-it, do te zbatohen gjithashtu mekanizma te reja dhe me te forte per monitorimin dhe vleresimin e programit. Do te krijohet nje mekanizem vjetor rishikues, i cili do te perfshije partneret nderkombetare, qeverine dhe shoqerine civile, per te rishikuar aktivitetet dhe per te vleresuar ecurine e programit te vendit si nje i tere, drejt rezultateve te identifikuara ne Kuadrin e Burimeve dhe Rezultateve. Per me teper, ZV-te do te punoje per te forcuar kapacitetet kombetare per monitorimin e ecurise se Shqiperise drejt arritjeve te OZHM-se. Si pjese e strategjise per Integrimin Gjinor, dhe ne kuadrin e raportit te KNZHKB-se, PNUD-i do te percaktoje dhe do te perdore per secilin projekt nje pakete treguesish qe jane te bazuar mbi ceshtjet gjinore.

7.3 Raporti i perbashket i SKZHI/OZHM dhe Raportet mbi Zhvillimin Njerezor Kombetar do te sherbejne si mjetet kryesore per raportimin mbi veprimtarine e KNZHKB-se, te plotesuara nga Raporti Vjetor dhe Plani i Punes se Koordinatorit te Perhershem.

7.4 PNUD-i do te mbeshtese perpjekjet e ndermarra te KM-se me partneret donatore per te monitoruar dhe vleresuar zbatimin e Deklaratave te Parisit dhe te Romes per ndihmen me efikase si dhe te seksioneve perkatese te Deklarates se Monterrey dhe Zhvillimit Financiar.

7.5 Ne projektet ZSHK-se partneret zbatues do te bashkepunojne me PNUD-in per te monitoruar te gjitha veprimtarite e mbeshtetura nga transferta cash dhe per te lehtesuar aksesin ne dokumentat perkatese te fondeve dhe personeli pergjegjes per administrimin e parave te dhene nga PNUD-i. Per kete arsye, partneret zbatues do te ndjekin kerkesat e meposhtme:

I). Rishikime periodike ne vend dhe kontrolle ne vend te dokumentave financiare te tyre nga PNUD-i ose perfaqesuesit e tij,

ii). Monitorim programatik i aktiviteteve qe ndjekin standardet dhe udhezimet e PNUD-it per vizitat dhe monitorimin ne teren.

iii). Auditime/kontrolle speciale dhe te planifikuara. Ne bashkepunim me agjensite e tjera te KB-se (atje ku eshte e nevojshme; dhe ne konsultim me ministrine koordinuese nese kjo eshte pjese e Modalitetit te Realizimit Kombetar), PNUD-i do te percaktoje nje plan auditimi vjetor, duke i dhene perparesi auditimeve te partnereve zbatues, te cileve u jane dhene ndihma te medha ne

para (cash) nga PNUD-i dhe auditimi i atyre partnereve zbatues kapaciteti i menaxhimit financiar te te cileve kerkon nje forcim.

7.6 Per te lehtesuar aktivitetet e sigurimit, partneret zbatues dhe PNUD-i do te bien dakort te perdorin nje program monitorimi dhe mjete kontrollit financiar qe te lejojne shkembimin e te dhenave dhe analizave.

7.7 Auditimet do te porositen nga PNUD-i dhe do te kryhen nga sherbime private te auditimit.

7.8 Vleresimi dhe auditimi i partnereve zbatues joqeveritare do te kryhet ne perputhje me politikat dhe procedurat e PNUD-it.

Pjes VIII. ANGAZHIMET E PNUD-it

8.1 PNUD-i i do te garantoje nje lidhje logjike ndermjet PVPSH 2006-2010/PVP, matrices se rezultateve te KNZHKB-ve dhe OZHM-ve, duke perfshire raportimin e monitorimit dhe vleresimit. Pergjegjesite e PNUD-it, KM-se dhe partnereve zbatues do te theksohen nepermjet rishikimeve vjetore dhe raportimit mbi ecurine.

8.2 Me kerkesen e KM-se, PNUD-i do te ofroje sherbimet e meposhtme mbeshtetese per aktivitetet ne ndihme te PVPSH 2006-2010:

i) Identifikim dhe ndihme ne dhe/ose rekrutimin e personelit te projektit dhe programit; prokurim te mallrave dhe sherbimeve ne perputhje me rregullat, normat, politikat dhe procedurat e PNUD-it;

ii). Identifikim dhe lehtesim te aktiviteteve te trajnimit, duke perfshire bursa studimi dhe udhetime studimore;

iii) Akses ne sistemin global te informacionit te menaxhuar nga PNUD-i, ne rrjetin e sistemit te informacionit te specializuar te zyrave te PNUD-it ne vend, duke perfshire konsulente te radhes dhe ofrues te sherbimeve per zhvillim;

iv) Akses ne mbeshtetjen e dhene nga rrjeti i agjensive te specializuara, fondeve dhe programeve te KB-se.

8.3 Persa i perket rregullave standarte te PNUD-it, ky i do te beje perpjekje rigoroze per te zbuluar dhe luftuar mashtrimet brenda programeve dhe projekteve te tij. Vete-auditime, auditime nga jashte, procedura te standartizuara per prokurimet, kontraktimi dhe punesimi si dhe praktika te tjera do te vazhdojne te perdoren per te siguruar nje integritet me te larte te punes se PNUD-it.

8.4 PNUD-i angazhon Burime te Rregullta qe shkojne ne shumen prej 7 milione USD$ gjate zhvillimit te Programit Për Vendin, 2006-2010, ne varesi te disponueshmerise se fondeve .

8.5 PNUD-i angazhohet te mobilizoje 37 milione USD$ gjate zhvillimit te PVPSH 2006-2010, ne varesi te interesit te donatoreve.

Si fondet e zakonshme ashtu dhe fondet nga burimet e tjera jane fonde te perftuara ekskluzivisht ne pergjigje te kerkesave per emergjenca.

Pjesa IX. ANGAZHIMET E KM-se

9.1 KM-ja do te pranoje angazhimet e saj ne perputhje me dispozitat e Marreveshjes Standarte te Ndihmes Baze (MSNB) te 17 qeshorit 1991. KM-ja do te zbatoje dispozitat e Konventes per Privilegjet dhe Imunitetin e Agjensive te KB ndaj vlerave, fondeve dhe pronave te PNUD-it dhe ndaj zyrtareve dhe konsulenteve te tij. Per me teper, KM-ja do t'i ofroje PNUD-it dhe zyrtareve te tij si dhe personelit qe kryen sherbime ne emer te PNUD-it, privilegjet, imunitetin dhe lehtesite qe jane parashikuar ne MSNB-te.

9.2 Ne perputhje me MSNB e firmosur nga Qeveria Shqiptare dhe PNUD-i, KM-ja do te marre masat e duhura administrative per shlyerjen ose rikthimin e cdo tarife apo takse per t'u paguar. Me tej

KM-ja do te vazhdoje te ofroje njoftime te menjehershme ne lidhje me cdo dhe te ndryshimet ne rregullat e TVSH-se te zbatueshme mbi agjensite e KB-se qe punojne ne Shqiperi.

9.3 Si nje kontribut per programin, do te nenshkruhen marreveshje per ndarjen e kostos me KM-ne. KM-ja do te vazhdoje te ndaje koston e projekteve te Fondit Global te Mjedisit (FGM) dhe do te kerkoje te mbeshtese kater nismat e reja prioritare (Lufta kunder Ekonomise Informale, Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit per Shkollat, Nisma per Thithjen e Trurit, Mjedisi dhe Turizmi) sipas Memorandumit te Mirekuptimit te firmosur ndermjet qeverise shqiptare dhe PNUD-it me 19 tetor 2005; do te vazhdojne te studiohen dhe mundesi te tjera te ndarjes se kostos. KM-ja angazhon gjithashtu burime jofinanciare per te mbeshtetur zbatimin e PVPSH 2006-2010 duke perfshire (por jo te kufizuar vetem ne) sa me poshte: perdorimin e zyrave dhe mjediseve te punes si dhe ekpertizen e punonjesve civile.

9.4 PNUD-i angazhohet te mbeshtese KM-ne ne perpjekjet e saj per te mbledhur fondet e kerkuara per te permbushur nevojat financiare te PVPSH 2006-2010.

9.5 Ne rastin e ndarjes se kostos nepermjet PVPSH 2006-2010, nenet e meposhtme jane te zbatueshme:

i). Nese pagesa behet ne nje valute te ndryshme nga dollari amerikan, vlera e saj do te percaktohet duke zbatuar kursin operues te shkembimit te KB-se ne fuqi ne daten qe behet pagesa. Ne rast ndryshimi te kursit operues te shkembimit perpara perdorimit te plote nga PNUD-i te pageses, vlera e bilancit te fondeve ende te paperdorura do te pershtatet ne varesi te ndryshimit ne ate kohe do te rregullohet sic duhet. Nese ne nje rast te tille, regjistrohet nje humbje ne vleren e bilancit te fondit, PNUD-i do te njoftoje KM-ne ne menyre qe te percaktohet nese KM-ja mund te ofroje ndonje financim te metejshem. Ne rast se nje financim i metejshem nuk eshte i mundshem, ndihma qe i jepet PVPSH 2006-2010 mund te ulet, pezullohet apo nderpritet nga PNUD-i.

ii). PNUD-i do te pranoje dhe administroje pagesat ne perputhje me rregulloret, normat dhe direktivat e PNUD.

iii). Te gjitha llogarite financiare dhe deklaratat financiare do te shprehen ne dollare amerikane.

iv). Nese priten apo verehen rritje te paparashikuara ne shpenzime apo angazhime (per shkak te inflacionit, luhatjeve te kursit te kembimit apo rastesive te pa parashikuara), PNUD-i do t'i paraqese KM-se ne kohe nje vleresim shtese, i cili do te pasqyroje financimet qe do te nevojiten metej. KM-ja do te perpiqet te siguroje fondet shtese te kerkuara.

v). Nese pagesat nuk jane marre ne perputhje me afatet e percaktuara per pagesat, ose nese financimi shtese i kerkuar ne perputhje me paragrafin iv me siper nuk eshte dhene nga KM-ja apo nga burime te tjera, ndihma qe eshte parashikuar t'i jepet PVPSH 2006-2010 sipas kesaj marreveshje mund te ulet, pezullohet, apo nderpritet nga PNUD-i.

vi). Cdo interes te ardhurash nga kontributi do t'i kreditohet llogarise bankare te PNUD-it, dhe do te perdoret ne perputhje me procedurat e percaktuara te PNUD-it.

vii). Ne perputhje me vendimet dhe direktivat e Bordit Ekzekutiv te PNUD-it te pasqyruara ne Politikat mbi Rigjenerimin e Kostos nga Burime te Tjera, Kontributi do t'i nenshtrohet rigjenerimit te kostos nga PNUD-i per dy kategori te vecanta te kostos qe kane te bejne me ofrimin e sherbimeve mbeshtetese, te quajtura:

a). Kosto jo te drejtperdrejta te shkaktuara nga Zyra Qendrore e PNUD-it dhe strukturat e Zyres per Vendin gjate ofrimit te sherbimeve ne Mbeshtetje te Menaxhimit te Pergjithshem (MMP). Per te mbuluar keto shpenzime te MMP-se, kontributit do t'i ngarkohet nje tarife jo me te ulet se 5%.

b). Kosto direkte per zbatimin e sherbimeve mbeshtetese (ZSHM) te ofruara nga PNUD-i dhe/ose nga nje ent zbatues ose partner zbatues. Per sa kohe qe keto jane te lidhura qartazi me projektin/programin specifik, keto shpenzime jane perfshire ne buxhetin e projektit ndaj nje zeri

perkates te buxhetit dhe, ne rastin e sherbimeve transferuese te identifikuara qarte, i faturohen projektit/programit ne perputhje me interesat standarte te sherbimeve.

Totali i shumave te buxhetuara per PVPSH 2006-2010, se bashku me kostot e perllogaritura te rimbursimit te sherbimeve perkatese mbeshtetese, nuk do te tejkaloje shumen e burimeve te disponueshme ne PVPSH 2006-2010 sipas kesaj marreveshjeje.

viii). Pronesia e pajisjeve, mjeteve dhe pasurive te tjera te financuara nga kontributi do te mbetet ne PNUD. Ceshtjet qe kane te bejne me transferimin e pronesise nga PNUD-i do te percaktohen ne perputhje me politikat dhe procedurat perkatese te PNUD-it.

ix). Kontributi do t'i nenshtrohet ne menyre eksluzive procedurave te auditimit te brendshem dhe te jashtem te percaktuara ne rregulloret financiare, rregullat dhe direktivat e PNUD-it.

9.6 PNUD-i dhe KM-ja jane te angazhuar qe te organizojne rishikime te herepashershme te programit, takime te perbashketa strategjike per planifikim, dhe atje ku shikohet e arsyeshme, koordinim te grupeve partnere sektoriale dhe tematike te zhvillimit, per te lehtesuar pjesemarrjen e donatoreve, shoqerise civile, sektorit privat dhe agjensive te KB-se. Per me teper , PNUD-i do te lehtesoje vizita te herepashershme monitorimi nga zyrtare te caktuar per te monitoruar, per t'u takuar me perfituesit, per te vleresuar ecurine dhe per te vleresuar ndikimin e perdorimit te burimeve te programit. KM-ja do t'i ofroje PNUD-it ne kohe informacion per cdo ndryshim ne politika apo legjislacion qe mund te behet gjate zbatimit te PVPSH 2006-2010 qe mund te ndikojne mbi bashkepunimin.

9.7 Nje raport standard i Autorizimit te Fondeve dhe Deshmise se Shpenzimeve (AFDSH), qe do te pasqyroje linjat e aktivitetit te PVP dhe/ose dokumente te projektit, do te perdoret nga partneret zbatues per projektet ZBK per te kerkuar dhenien [leshimin] e fondeve ose per te siguruar marreveshjen qe PNUD-i do te rimbursoje ose do te paguaje drejtperdrejt per shpenzimet e planifikuara. Partneret Zbatues do te perdorin AFDSH per te raportuar mbi perdorimin e parave te marra. Partneret Zbatues duhet te percaktojne zyrtarin/zyrtaret e percaktuar te autorizuar per te ofruar detaje mbi llogarite bankare, per te kerkuar dhe deshmuar perdorimin e parave. AFDSH do te certifikohet nga zyrtari/zyrtaret e emeruar te partnereve zyrtare.

9.8 Parate (cash) te transferuara tek partneri zbatues duhet te shpenzohen per qellim aktiviteti, sic eshte rene dakort ne vetem ne PVP dhe/ose ne dokumentet e projektit.

9.9 Parate e marra nga qeveria dhe partneret zbatues qe jane OJQ-te vendase do te perdoren ne perputhje me rregullat, politikat dhe procedurat kombetare te percakuara, te cilat jane ne përputhje me standardet ndërkombëtare, veçanarisht për të siguruar që raportet mbi përdorimin e plotë të të gjithë parave të marra të dorëzohen PNUD-it brenda një afati gjashtë mujor pas marrjes së fondeve. Në rastin kur rregullat, politikat dhe proçedurat kombëtare nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, rregullat, politikat dhe proçedurat e agjensive të KB-së do të zbatohen në këtë rast.

9.10 Në rastin kur partnerë zbatues janë OJQ-të ndërkombëtare dhe Organizata Ndërkombëtare Qeveritare, paratë e marra do të përdoren në përputhje me standartet ndërkombëtare, veçanërisht për t'u siguruar se paratë janë shpenzuar për aktivitetet e rëna dakort në PVP dhe/ose në dokumentet e projektit, dhe për të siguruar që raportet mbi përdorimin e plotë të të gjithë parave të marra të dorëzohen PNUD-it brenda një afati gjashtë mujor pas marrjes së fondeve.

9.11 Për të lehtesuar auditimet e planifikuara dhe te vecanta, secili prej partnereve zbatues qe ka marre para (cash) nga PNUD do t'i ofroje PNUD-it apo perfaqesuesve te tij akses ne kohe ne:

- Te gjitha dokumentat financiare qe tregojne transaksionet e transfertave te parave (cash) te dhene nga PNUD-i
- Te gjitha dokumentat dhe personelin perkates qe punon ne strukturat e brendshme te kontrollit te partnerit zbatues ndermjet te cilit ka kaluar transfertat e parave.

9.12 Gjetjet e cdo auditimi do t'i raportohen partnerit zbatues dhe PNUD-i. Me tej, cdo partner zbatues do:

- Te marre dhe te rishikoje raportin e auditimit te leshuar nga auditoret
- T'i ofroje PNUD-it qe ka ofruar parate nje deklarate ne kohe, ne lidhje me pranimin apo refuzimin e ndonje nga rekomandimeve te auditimit
- Te ndermarre veprime ne kohe per te trajtuar dhe pranuar rekomandimet e auditimit.
- Te raportoje tek agjensite e KB-se cdo tre-mujor mbi veprimet e ndermarra per te zbatuar rekomandimet

PJESA X. DISPOZITA TË TJERA

10.1 Ky PVPSH 2006-2010 zëvendëson cdo Plan Veprimi të Programit për Vendin të mëparshëm të nënshkruar nga Qeveria Shqiptare dhe PNUD-i dhe mund të ndryshohet me miratim e përbashkët të të dy palëve bazuar në rekomandimet e takime për strategjinë e përbashkët.

NË DËSHMI TË SA MËSIPËR, të nënshkruarit, të autorizuar përkatësisht, kanë firmosur këtë Plan Veprimesh të Programit Për Shqipërinë 2006-2010 sot në Tiranë, Shqipëri.

Për Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara

Firma: _____

Emri: Gülden Turüköz-Cosslett

Titulli: Përfaqësues i Përhershëm i PNUD në Shqipëri

Data: 11.04.2006

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Firma: _____

Emri: Ilir Rusmali

Titulli: Zëvendëskryeministër

Data: 11.04.2006

Akronime

ZHBZ	Zhvillimi në Bazë Zonash
PVP	Plani Vjetor i Punës
PVPSH	Plani i Veprimeve të Programit Për Shqipërinë
OBK	Organizatë me Bazë Komuniteti
KDB	Konventa për Diversitetin Biologjik
KM	Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
KZHDG	Konventa për Zhdukjen e të Gjitha Llojeve të Diskriminimit ndaj Grave
OSHC	Organizate e Shoqërisë Civile
ZD	Zbatim i Drejtpërdrejtë
DKSD	Departamenti i Koordinimit të Strategjive dhe Donatorëve
STD	Sekretariati Teknik i Donatorëve
KE	Komisioni Europian
BE	Bashkimi Europian
AFDSH	Autorizimi i Fondeve dhe Dëshmia e Shpenzimeve
QSH	Qeveria Shqiptare
FGM	Fondi Global për Mjedisin
SHMMP	Shërbimet në Mbështetje të Menaxhimit të Përgjithshëm
TIK	Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit
TIKZH	Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit per Zhvillim
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
SHMZ	Shërbimet në Mbeshtetje të Zbatimit
TSP	Takime Strategjike të Përbashkëta
PQV	Programi për Qeverisjen Për Vendin
OZHM	Objektivat për Zhvillim të Mjëvjecarit
ROZHM	Raporti mbi Objektivat për Zhvillim të Mjëvjecarit
PBAM	Programi i Buxhetit Afat-Mesëm
ZSHK	Zbatimi në Shkallë Kombëtare
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
SKZHES	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
QPA	Qendër Publike e Aksesit
NOQ	Ndotës Organik i Qëndrueshëm
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
MSNB	Marrëveshja Standarte për Ndihmën Bazë
KKBLKSH	Konventa e Kombeve të Bashkuara për Luftën Kundër Shkretimit
KNZHKB	Kuadri i Ndihmës për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
GZHKB	Grupi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
KKKBNK	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin e Klimës
MP	Municion i Pashpërthyer
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë

















